



KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS
RAPORTI VJETOR
2019



2019

Shkurt, 2020



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës
Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Raporti vjetor 2019

Këshilli Prokurorial i Kosovës

Shkurt, 2020

© Këshilli Prokurorial i Kosovës 2020

Publikuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përbajtja e këtij materiali nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

SHKURTESAT

KËSHILLI	Këshilli Prokurorial i Kosovës
PSH	Prokurori i Shtetit
ZKPSH	Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit
PA	Prokuroria e Apelit
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
PTH	Prokuroria Themelore
DKR	Departamenti i Krimeve të Rënda
DM	Departamenti për të Mitur
DP	Departamenti i Përgjithshëm
Sekretariati	Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës
Njësiti	Njësiti për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive
ZMNV	Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave
ZMAVP	Zyra për Mbikëqyrje, Analitikë dhe Verifikim Prokurorial

Përmbajtja	
I. PJESA E PARË	8
Përmbledhje ekzekutive	8
1. Vizioni.....	9
2. Misioni.....	9
3. Mandati i Këshillit.....	9
II. PJESA E DYTË	11
4. Aktivitetet e Këshillit.....	11
4.1. Zgjedhja e Kryesuesit dhe anëtarëve të Këshillit.....	11
4.2. Rekrutimi i prokurorëve të shtetit.....	11
4.3. Procesi i emërimit të Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë.....	12
4.4. Transferimi dhe avancimi i prokurorëve	12
4.5. Trajnimi i prokurorëve.....	13
4.6. Miratimi i akteve nënligjore dhe dokumenteve të tjera (ndryshimet ligjore me përfshirje edhe Ligji e Këshillit	14
4.7. Miratimi i vendimeve.....	15
4.8. Miratimi i dokumenteve strategjike.....	15
4.9. Aktivitetet e Kryesuesit të Këshillit.....	15
4.9.1. Takimet me partnerë ndërkombëtarë.....	15
4.9.2. Vizitat jashtë vendit	16
4.9.3. Pjesëmarrja e Kryesuesit në konferenca dhe tryeza.....	16
4.10. Puna e Komisioneve të Këshillit.....	17
4.10.1. Komisionet e përhershme.....	17
4.10.1.1. Komisioni për Çështje Normative.....	17
4.10.1.2. Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel.....	18
4.10.1.3. Procedurat disiplinore.....	19
4.10.1.4. Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve.....	19
4.10.1.5. Komisioni për Administrimin e Prokurorive.....	23
4.10.2. Komisionet ad hoc	24

4.10.2.1. Komisioni për Rekrutim.....	24
4.10.2.2. Komisioni për Rishqyrtim.....	24
4.10.2.3. Komisioni për Transferim dhe Avancim.....	24
4.10.2.4. Panelet vlerësuese për proceset e emërimit të kryeprokurorëve.....	24
4.10.2.5. Komisionet për rishqyrtim për proceset e emërimit të kryeprokurorëve.....	25
4.10.2.6. Grupi punues për monitorim të zbatimit të Planit strategjik të sistemit prokurorial 2019-2021.....	25
4.10.2.7. Grupi punues për zbatim të detyrave specifike që dalin nga Plani strategjik i sistemit prokurorial 2019-2021.....	25
4.10.2.8. Grupi punues për mbikëqyrjen e Njësitit për luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike që del nga Plani strategjik i sistemit prokurorial 2019-2021.....	25
III. PJESA E TRETË.....	26
5. Buxheti i Këshillit.....	26
5.1. Realizimi i buxhetit janar - dhjetor 2019.....	28
5.2. Paga dhe mëditje.....	28
5.3. Mallra dhe shërbime.....	29
5.4. Shpenzimet komunale.....	31
5.5. Shpenzimet kapitale.....	33
5.6. Të hyrat.....	33
5.7. Donacionet.....	34
IV. PJESA E KATËRT.....	35
6. Bashkëpunimi me institucione dhe organizata të tjera.....	35
V. PJESA E PESTË.....	37
7. Raporti vjetor i punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2019.....	37
7.1. Kallëzimet – lëndët penale në punë nga Prokurori i Shtetit.....	37
7.2. Lëndët e bartura nga viti 2018 në vitin 2019.....	38
7.3. Lëndët e pranuar në vitin 2019.....	39
7.4. Lëndët e zgjidhura.....	40
7.5. Lëndët e pazgjidhura.....	41

7.6. Lëndët në punë, të zgjidhura dhe të pazgjidhura.....	42
7.7. Krahasimi i lëndëve të pranuara dhe të zgjidhura mes 2018 dhe 2019.....	43
7.8. Trajtimi i rasteve me procedura alternative dhe urdhra ndëshkimorë.....	44
7.9. Parashtruesit e kallëzimeve penale.....	45
7.9.1. Parashtruesit e kallëzimeve penale të kryesve madhorë të veprave penale (PP).....	45
7.9.2. Parashtruesit e kallëzimeve penale të kryesve të mitur të veprave penale (PPM).....	46
7.10. Kallëzimet penale sipas prokurorive.....	47
VI. PJESA E GJASHTË.....	48
8. Aktivitetet e Sekretariatit të Këshillit.....	48
8.1. Zyra e Drejtorit.....	49
8.1.1. Auditimi i Brendshëm.....	49
8.1.2. Certifikimi i lëndëve për pagesë.....	50
8.1.3. Zyra Ligjore.....	51
8.1.4. Zyra për Komunikim Publik.....	51
8.2. Departamenti për Burime Njerëzore, Prokurim dhe Administratë.....	52
8.2.1. Divizioni për Burime Njerëzore.....	53
8.2.2. Divizioni për Prokurim.....	54
8.2.3. Divizioni i Administratës.....	56
8.3. Departamenti për Buxhet, Financa dhe Shërbime të Përgjithshme.....	56
8.3.1. Divizioni për Buxhet dhe Financa.....	57
8.3.2. Divizioni për Shërbime të Përgjithshme.....	58
8.4. Departamenti për Teknologji Informative.....	59
8.4.1. Divizioni i Infrastrukturës (rrjet dhe server).....	60
8.4.2. Divizioni për Sisteme Elektronike (softuer).....	61
8.5. Projekti TIK/SMIL.....	62
VII. PJESA E SHTATË.....	64
9. Aktivitetet e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë.....	64
9.1. Zyra për Mbikëqyrje, Analitikë dhe Verifikim Prokurorial.....	64

9.2. Mbështetja e komisioneve të Këshillit.....	64
9.3. Hartimi i raporteve.....	65
9.4. Zyra për Statistika.....	66
9.4.1. Mbështetja e komisioneve, koordinatorëve nacionalë, DTI-së dhe ZMAVP-it.....	66
9.4.2. Raportet e rregullta.....	67
9.4.3. Raportet e veçanta.....	68
9.5. Zyra për Trajnime.....	68
10. Sfidat.....	69

I. PJESA E PARË

Përmbledhje ekzekutive

Raporti i punës për vitin 2019 paraqet aktivitetet dhe veprimtarinë e zhvilluar njëvjeçare të Këshillit Prokurorial në kuadër të realizimit të vizionit dhe mandatit kushtetues dhe ligjor, si institucion i pavarur në ushtrimin e funksioneve të veta me qëllim të sigurimit të një sistemi prokurorial të pavarur, profesional dhe të paanshëm.

Ky raport përbëhet nga pjesë të standardizuara të realizimit të punëve gjatë vitit 2019, të cilat pasqyrojnë aspekte të veçanta për Këshillin, me ç'rast në *pjesën e parë* apo *hyrëse* janë paraqitur vizioni, misioni, struktura, kompetencat dhe baza ligjore e funksionimit të Këshillit, kurse në *pjesën e dytë*, aktivitetet e Këshillit, si: rekrutimi, transferimi dhe avancimi i prokurorëve, aktivitetet e Kryesuesit të Këshillit, hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore (rregulloret, udhëzimet administrative dhe vendimet), dokumentet strategjike dhe aktivitetet e trupave të Këshillit (komisioneve të përhershme dhe komisioneve ad hoc).

Raporti vjetor i punës për vitin 2019 i Këshillit, në *pjesën tretë*, përmban të dhëna të çmueshme për buxhetin e sistemit prokurorial, me ç'rast vëmendje të veçantë kanë pasur shpenzimet për kategoritë e pagave dhe mëditjeve, mallrave dhe shërbimeve, shpenzimeve komunale dhe investimeve kapitale për të gjitha programet buxhetore të Këshillit.

Në pjesën e katërt të këtij raporti pasqyrohet bashkëpunimi vendor dhe ndërkombëtar.

Në *pjesën e pestë* është paraqitur Raporti vjetor i punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2019, i cili përfshin kallëzimet penale në punë, lëndët e bartura, lëndët e pranuar, lëndët e zgjidhura dhe të pazgjidhura, trajtimin e rasteve me procedura alternative dhe me urdhra ndëshkimore dhe parashtresit e kallëzimeve penale.

Gjithashtu në vijimësi të *pjesës së gjashtë* prezantohen aktivitetet e Sekretariatit në kuadër të menaxhimit të burimeve njerëzore, buxhetit dhe financave, shërbimeve të përgjithshme, teknologjisë informative dhe komunikimit publik. Ndër të tjera, në këtë dokument të rëndësishëm, në *pjesën e shtatë*, prezantohet edhe puna e Njësitit, e cila ka në fokus mbështetjen e proceseve të shqyrtimit të performancës së prokurorëve, rekrutimit të prokurorëve, përpilimin e raporteve statistikore dhe analitike, mbikëqyrjen e regjistrave në prokurori dhe trajnimin e prokurorëve, ndërsa në fund janë paraqitur sfidat kryesore, me të cilat është ballafaquar Këshilli gjatë vitit 2019.

1. Vizioni

Vizioni i Këshillit është puna e vazhdueshme për arritjen e standardeve dhe vlerave më të larta të ndershmërisë, integritetit, profesionalizmit dhe transparencës së sistemit prokurorial të Kosovës përmes bërjes së politikave dhe marrjes së vendimeve të cilat sigurojnë pavarësinë, paanshmërinë dhe efikasitetin e tij.

2. Misioni

Misioni i Këshillit është sigurimi i sistemit të pavarur, të paanshëm, profesional dhe efektiv i hetimit dhe i ndjekjes penale nga prokurorë të rekrutuar në bazë të meritës, të vlerësuar në bazë të rezultateve në punë dhe të mbikëqyrur sipas standardeve të larta, i cili siguron zbatimin e ligjit në mënyrë të drejtë e pa dallime dhe i trajton në mënyrë meritore viktimat e krimit.

3. Mandati i Këshillit

Mandati i Këshillit buron nga Kushtetuta dhe ligji që e përcaktojnë atë si një institucion të pavarur në ushtrimin e funksioneve prokuroriale.

Në muajin mars të vitit 2019 është miratuar Ligji nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, i cili ka përcaktuar detyrat, përgjegjësitë, organizimin dhe funksionimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Përgjegjësitë kryesore kushtetuese dhe ligjore të Këshillit janë si në vijim:

- a. Siguron që prokurorët të veprojnë në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të paanshme gjatë kryerjes së të gjitha funksioneve prokuroriale;
- b. Vendos për organizimin, menaxhimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të prokurorive sipas ligjit përfshirë edhe numrin e prokurorëve në secilin Prokurori;
- c. Rekruton dhe propozon te Presidenti kandidatët për emërim dhe riemërim për prokurorë dhe kryeprokurorë përfshirë edhe Kryeprokurorin e Shtetit;
- d. Përgatit, dërgon dhe mbikëqyrë buxhetin e Prokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial;
- e. Në bashkëpunim me Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit zhvillon politikën dhe strategjitë prokuroriale për luftimin efektiv të kriminalitetit;
- f. Vlerëson, ngritë në detyrë, disiplinon, shkarkon, transferon dhe ofron mbështetje për trajnimin e prokurorëve;
- g. Zhvillon standardet për rekrutimin, organizimin dhe shpalljen e provimit për kualifikimin e prokurorëve;

- h. Miraton aktet nënligjore në funksion të zbatimit të detyrave dhe përgjegjësive të tij, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- i. Përgatitë raport vjetor për veprimtaritë dhe shpenzimet e Prokurorit të Shtetit dhe Këshillit si dhe raporton para publikut për zbatimin e objektivave të saj të përcaktuara në mënyrë specifike dhe të bazuar në indikatorë të matshëm.

II. PJESA E DYTË

4. Aktivitetet e Këshillit

Këshilli ka përmbushur mandatin e tij ligjor gjatë vitit 2019 përmes organizimit të takimeve të rregullta, në të cilat janë marrë vendime të ndryshme për procesin e rekrutimit, transferimit, avancimit të prokurorëve, procedurave të disiplinimit dhe procesit të vlerësimit të performancës së prokurorëve.

Në këtë aspekt, Këshilli ka menaxhuar buxhetin vjetor të dedikuar për sistemin prokurorial të Kosovës, është angazhuar në përmirësimin e kushteve infrastrukturore për prokurorët dhe për stafin mbështetës, si dhe ka ngritur kapacitetet profesionale të prokurorëve dhe stafit mbështetës përmes bashkëpunimit, propozimit, koordinimit dhe mbikëqyrjes së trajnimeve të ndryshme, përfshirë kryesisht Akademinë e Drejtësisë, por edhe partnerët vendës dhe ndërkombëtarë.

Megjithatë, në radhën e aktiviteteve kryesore të Këshillit përgjatë vitit 2019 mund të përmendim rekrutimin e prokurorëve, emërimin e kryeprokurorëve, vlerësimin e performancës, disiplinimin, transferimin, avancimin e prokurorëve dhe zhvillimin e kapaciteteve.

Gjithashtu, trupat e Këshillit kanë zhvilluar aktivitete të ndryshme në kuadër të realizimit të mandatit të tyre dhe në shërbim të funksionimit dhe mbarëvajtjes së rregullt të sistemit prokurorial.

4.1. Zgjedhja e Kryesuesit dhe anëtarëve të Këshillit

Përbërja e Këshillit, siç përcaktohet me ligj, ka filluar funksionimin nga 1 janari i vitit 2016 pas përzgjedhjes së anëtarëve prokurorë nga të gjitha nivelet e institucionit të Prokurorit të Shtetit, me ç'rast është përmbushur obligimi ligjor për zgjedhjen e dhjetë (10) anëtarëve prokurorë.

Në fillim të vitit 2019, pas skadimit të mandatit të Kryesuesit paraprak, u zgjodh Kryesuesi i ri i Këshillit. Gjithashtu, në mars të vitit 2019 ka filluar mandatin si anëtare e re e Këshillit një prokurore nga radhët e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.

Sa i përket zgjedhjes së tre anëtarëve jo prokurorë të Këshillit, kjo ende nuk është realizuar edhe pse Këshilli në vazhdimësi ka bërë kërkesë në Kuvendin e Kosovës për zhvillimin e procedurave për zgjedhjen e këtyre anëtarëve ashtu siç paashihet me Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

4.2. Rekrutimi i prokurorëve të shtetit

Në fillim të vitit 2019, Këshilli ka përfunduar të gjitha procedurat për rekrutimin e

12 prokurorëve të rinj, të cilët u dekretuan nga Presidenti i Republikës së Kosovës më 7 maj 2019. Të njëjtit kanë filluar dhe janë duke ndjekur trajnimin fillestar njëvjeçar në Akademinë e Drejtësisë.

Vlen të theksohet se procesi i rekrutimit të prokurorëve të rinj është monitoruar nga shoqëria civile, OSBE-ja dhe përfaqësuesit e Projektit britanik "Forcimi i sistemit gjyqësor në Kosovë".

4.3. Procesi i emërimit të Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë

Këshilli, pas daljes në pension të Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ka filluar procedurën për plotësimin e këtyre dy pozitave. Këtij procesi fillimisht i ka paraprirë hartimi dhe miratimi i Rregullores për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe kryeprokurorëve të prokurorive të Republikës së Kosovës, bazuar dhe mbështetur në vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe në praktikat më të mira ndërkombëtare.

Sipas vendimeve të Këshillit, është shpallur konkursi për zgjedhjen e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe Kryeprokurorit të PSRK-së. Në procesin për emërimin e Kryeprokurorit të PSRK-së aplikuan pesë (5) kandidatë, ndërsa në atë për emërimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë aplikuan katër (4) kandidatë.

Më 3 shtator 2019, Këshilli pas tërheqjes së shortit miratoi përbërjen e paneleve vlerësuese dhe komisioneve për rishqyrtim për proceset e emërimit të Kryeprokurorit të PSRK-së dhe Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë. Në pajtim me Rregulloren për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe kryeprokurorëve të prokurorive të Republikës së Kosovës, u konfirmua statusi i kandidatëve dhe u njoftuan kandidatët, të cilët i plotësonin kriteret dhe u publikua lista përfundimtare.

Pas mbajtjes së intervistave dhe shqyrtimit të kundërshtimeve brenda afateve të përcaktuara me rregullore, Këshilli në takimin e datës 23 dhjetor 2019, pas procesit të votimit, emëroi Kryeprokurorin e PSRK-së dhe Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë.

I gjithë procesi është monitoruar nga përfaqësues të Ambasadës Amerikane, Ambasadës Britanike, projektit britanik, Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, BIRN-it dhe Grupit për Studime Juridike dhe Politike.

4.4. Transferimi dhe avancimi i prokurorëve

Këshilli, përmes Komisionit për Transferimin dhe Avancimin e prokurorëve, ka zhvilluar disa procese, përmes të cilave janë avancuar prokurorët si në vijim:

- Një (1) prokuror në DM të PTH në Pejë;
- Një (1) prokuror në DM të PTH në Ferizaj;
- Dy (2) prokurorë në DKR të PTH në Prishtinë;
- Një (1) prokuror në DM të PTH në Gjakovë;
- Një (1) prokuror në DKR të PTH në Gjakovë.

Gjithashtu, Këshilli, gjatë vitit 2019, ka transferuar prokurorët si në vijim:

- Një (1) prokuror nga DP të PTH në Mitrovicë në DP të PTH në Prishtinë;
- Një (1) prokuror nga DP i PTH në Prishtinë në DP të PTH në Mitrovicë;
- Një (1) prokuror nga DM në DKR të PTH në Prizren;
- Një (1) prokuror nga DP i PTH në Ferizaj në DP të PTH në Mitrovicë.

4.5. Trajnimi i prokurorëve

Prokurorët e shtetit kanë marrë pjesë përgjatë vitit kalendarik në trajnime, punëtori dhe vizita studimore, në të cilat janë trajtuar 98 (nëntëdhjetetë) tema të ndryshme, ndër të cilat ka mbizotëruar: E drejta penale dhe procedurale, të drejtat e njeriut në Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, krimi i organizuar, trafikimi i qenieve njerëzore, krimet financiare, terrorizmi, menaxhimi i dëshmitarëve, bashkëpunimi juridik ndërkombëtar, korrupsioni, krimi kibernetik, forenzika ligjore, etika profesionale, administrimi i prokurorisë, dhe zhvillimi i shkathtësive praktike të prokurorëve, komunikimi publik në situata krizash etj.

Në koordinim të Njësitit, prokurorët të cilët kanë marrë pjesën në aktivitetet të ndryshme të arsimimit ligjor, prej 197 prokurorëve aktualë, kanë marrë pjesë 152 prokurorë¹ në trajnimet të vazhdueshme dhe për avancim, ndërsa në trajnime fillestare për prokurorë të posarekrutuar kanë marrë pjesë 12.

Numri i përgjithshëm i pjesëmarrjes në trajnime është 523 dhe atë si në vijim:

- Prokurorët nga ZKPSH-ja kanë ndjekur 14 trajnime;
- Prokurorët nga PA-ja kanë ndjekur 11 trajnime;
- Prokurorët nga PSRK-ja kanë ndjekur 14 trajnime;
- Prokurorët nga PTH e Prishtinës kanë ndjekur 151 trajnime;
- Prokurorët nga PTH e Prizrenit kanë ndjekur 70 trajnime;
- Prokurorët nga PTH e Pejës kanë ndjekur 29 trajnime;

¹ Sqarim: Numri prej 152 prokurorëve që kanë marrë pjesë në trajnime nënkupton se 1 prokuror ka mundur të ndjekë më shumë se 1 trajnim.

- Prokurorët nga PTH e Mitrovicës kanë ndjekur 75 trajnime;
- Prokurorët nga PTH e Gjilanit kanë ndjekur 44 trajnime;
- Prokurorët nga PTH e Gjakovës kanë ndjekur 30 trajnime;
- Prokurorët nga PTH e Ferizajit kanë ndjekur 11 trajnime.

Prokurorët kanë marrë pjesë në trajnime edhe jashtë vendit, si në: Shqipëri, Mal të Zi, Itali, SHBA, Kroaci, Francë, Maqedoni, Britani të Madhe, Maltë, etj.

Përveç tjerash, prokurorët kanë marrë pjesë në programet e trajnimit të Akademisë së Drejtësisë në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme, fillestare dhe atyre për avancim.

Në këtë kontekst, në kuadër të bashkëpunimit me Akademinë, Këshilli ka hartuar dokumentin “Politikat e trajnimit për prokurorë dhe staf administrativ të sistemit prokurorial”, me anë të të cilit është kërkuar nga Akademia që të përgatisë programe trajnimi adekuate dhe të ftojë prokurorë në trajnime sipas specifikave.

Në trajnimet e prokurorëve, në cilësinë e trajnuesve ishin angazhuar gjithsej 17 prokurorë.

4.6. Miratimi i akteve nënligjore dhe dokumenteve të tjera (ndryshimet ligjore me përfshirje edhe Ligji e Këshillit

Ndryshimet ligjore të ndërlidhura me sistemin prokurorial, të cilat kanë hyrë në fuqi gjatë vitit 2019 kishin obliguar Këshillin që të hartojë dhe miratojë akte nënligjore në kuadër të Planit të punës për vitin 2019.

Gjatë vitit 2019, Këshilli ka miratuar 6 rregullore si në vijim:

- Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr.08.2016 për emërimin e kryeprokurorëve;
- Rregulloren për administrimin dhe ndarjen e lëndëve në Prokurorin e Shtetit;
- Rregulloren për Shërbimin e Komunikimit Publik në sistemin prokurorial;
- Rregulloren për procedurën e ndërmjetësimit të rasteve nga prokuroria;
- Rregulloren për procedurën disiplinore të prokurorëve;
- Rregulloren për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe kryeprokurorëve të prokurorive të Republikës së Kosovës.

Në miratimin e këtyre rregulloreve janë angazhuar komisionet dhe trupat e tjerë ndihmës të Këshillit dhe Sekretariatit dhe me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë (ekspertë të angazhuar nga Ambasada Amerikane, Ambasada Britanike, Zyra e BE-së, UNDP-ja, etj).

4.7. Miratimi i vendimeve

Këshilli, gjatë vitit 2019 ka marrë 215 vendime nga fushë veprimtaria e tij. Këto vendime kanë të bëjnë me zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit, themelimin e komisioneve të përhershme dhe ad-hoc, rekrutimin, transferimin dhe avancimin e prokurorëve, disiplinimin dhe vlerësimin e performancës së prokurorëve, administrimin prokurorive, menaxhimin e buxhetit, miratimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të punës, procesin e integriteteve evropiane dhe vendime të tjera, të cilat i përkasin bashkëpunimit institucional.

4.8. Miratimi i dokumenteve strategjike

Gjatë këtij viti, Këshilli ka miratuar Planin Strategjik të sistemit prokurorial 2019-2021 ku janë përcaktuar objektivat trevjeçare të sistemit prokurorial.

Këshilli ka miratuar edhe Strategjinë për Krime të Luftës dhe ka themeluar mekanizmat e paraparë për implementimin e kësaj strategjie, si: Task Forcën dhe Grupi monitorues që në përbërjen e tyre kanë përfaqësues të KPK-së, PSH-së, Policisë së Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë. Vlen të përmendet se ky dokument është me karakter nacional dhe ka mundësuar që Departamenti për Krime Luftë të trajtojë me prioritet rastet e kësaj natyre.

4.9. Aktivitetet e Kryesuesit të Këshillit

Gjatë vitit 2019, duke u bazuar në kompetencat ligjore për përfaqësimin e Këshillit para publikut, institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, Kryesuesi i Këshillit ka zhvilluar veprimtari përfaqësuese, si: takime, vizita dhe ka marrë pjesë në konferenca, vizita studimore dhe tryeza të ndryshme.

4.9.1. Takimet me partnerë ndërkombëtarë

Kryesuesi i Këshillit ka pasë takime të rregullta me përfaqësuesit e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, në kuadër të frymës së bashkëpunimit dhe mbështetjes, të cilën shteti amerikan ofron gjithnjë për sistemin prokurorial në Kosovë.

Kryesuesi ka zhvilluar takime edhe me përfaqësues të institucioneve të tjera ndërkombëtare, si: Zyrës së BE-së në Prishtinë, Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar, UNDP-së dhe agjencive të tjera të Kombeve të Bashkuara, Ambasadës së Norvegjisë, Ambasadës së Holandës, Këshillit të Evropës, OSCE, GIZ-it etj.

Gjatë këtyre takimeve është biseduar për projektet e ndryshme në mbështetje të sistemit prokurorial të Kosovës, të cilat realizohen në kuadër të financimit dhe përkrahjes së institucioneve të lartcekura.

4.9.2. Vizitat jashtë vendit

Kryesuesi dhe anëtarët e Këshillit kanë zhvilluar një vizitë zyrtare në Bolzano, Itali, në shkurt të vitit 2019, ku kanë vizituar institucione të ndryshme të sundimit të ligjit. Qëllimi i kësaj vizite ishte shkëmbimi i përvojave me përfaqësuesit e sistemit të drejtësisë në provincën e Bolzanos për zgjidhjet e rasteve, përvojat, modelet e mbrojtjes së pakicave, aktiviteteteve e kryera gjatë shqyrtimit dhe krahasimit të realitetit italian dhe kosovar në rastet e mbrojtjes së minoriteteve dhe mbrojtjes së komponentëve të ndryshme gjuhësore në sistemin ligjor italian

Po ashtu, Kryesuesi ka marrë pjesë edhe në një vizitë studimore në Vjenë, Austri, ku janë trajtuar temat e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Kjo vizitë studimore është organizuar nga Ministria Federale e Financave të Austrisë dhe Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drojë dhe Krim (UNODC).

Në kuadër të Planit të punës për implementimin e Udhëzuesit për politikë ndëshkimore në Kosovë, Kryesuesi ka qëndruar në një vizitë njëjavore në Minnesota, SHBA, ku ka mbajtur takime të ndryshme me kryeprokurorë, prokurorë, gjyqtarë, përfaqësues të Komisionit për politikë ndëshkimore, etj.

Në maj dhe nëntor të këtij viti, Kryesuesi mori pjesë në tryezat për koordinim rajonal për zbatimin e Udhërrëfyesit për një zgjidhje të qëndrueshme për mbajtjen e paligjshme, keqpërdorimin dhe trafikimin e armëve të vogla dhe të lehta dhe municioneve të tyre në Ballkanin Perëndimor deri në vitin 2024, eveniment ky, i financuar nga Bashkimi Evropian. Këto tryeza u mbajtën në Sarajevë dhe Tiranë.

4.9.3. Pjesëmarrja e Kryesuesit në konferenca dhe tryeza

Në përmbushje të mandatit për përfaqësim të Këshillit, Kryesuesi ka marrë pjesë edhe në konferenca dhe tryeza pune, si në vijim, si dhe në:

- Konferencën Vjetore të Prokurorëve, e cila është organizuar nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit në shkurt të vitit 2019;
- Tryezën e diskutimit për Ligjin për ndërmjetësim;
- Prezantimin e Ligjit të ri për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë;
- Takimet e Bordit Drejtues të Projektit TIK/SMIL;
- Tryezën lidhur me hartimin e Udhëzuesit për politikën ndëshkimore;
- Konferencën përmblylëse të Programit “Promovimi i integritetit në sistemin gjyqësor”;
- Tryezën me temën “Pandëshkueshmëria e korrupsionit - rrezik për shoqërinë dhe shtetin”, “Zgjidhja: Integritet, transparencë, llogaridhënie”;
- Konferencën me temën “Korrupsioni i nivelit të lartë”;
- Panelist: Fondi për Drejtën Humanitare, “Strategjia e Krimeve të Luftës”;
- Panelist në tryezën “Mundësitë e barabarta për komunitetet joshumicë në gjyqësor”;

- Rishikimin funksional i sektorit të sundimit të ligjit, të gjeturat nga Dokumenti i politikave “Rritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial”;
- Seminarin për dënimet dhe masat alternative, rritjen e përdorimit dhe zbatimit të dënimeve dhe masave alternative;
- Punëtorinë lidhur me organizimin e administratës së sistemit prokurorial;
- Punëtorinë lidhur me hartimin e Rregullores për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe kryeprokurorëve të prokurorive të Kosovës;
- Punëtorinë lidhur me dispozitat e reja rreth konfiskimit;
- Tryezën e diskutimit rreth implementimit të Ligjit dhe Rregullores për disiplinimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- Tryezën e diskutimit: Qasja në drejtësi, Raporti i monitorimit të gjykatave tetor 2018 - shtator 2019;
- Tryezën e diskutimit të Institutit të Kosovës për Drejtësi “Amnistia e korrupsionit të profilit të lartë (sinjalizimet e padëgjuaara të korrupsionit nga drejtësia);
- Tryezën me temën: “Të drejtat e njeriut sfidat dhe problemet në realizimin e tyre”;
- Pjesëmarrjen me rastin e “Javës për mbrojtje dhe ndihmë viktimave të krimit”.

Në kuadër të përfaqësimit të prezantuar më lart, Kryesuesi në vazhdimësi ka adresuar pikëpamjet, punën e Këshillit dhe zhvillimet në sistemit prokurorial në varësi të agjendave të këtyre forumeve.

4.10. Puna e Komisioneve të Këshillit

Këshilli realizon mandatin e tij edhe përmes komisioneve të përhershme dhe atyre që themelohen për një mandat të caktuar – ad hoc. Në vijim do të paraqesim punën e komisioneve gjatë vitit 2019.

4.10.1. Komisionet e përhershme

Të gjitha komisionet e përhershme, të cilat funksionojnë në kuadër të Këshillit kanë rregullat e tyre të punës dhe fushëveprimtarinë e ushtrojnë në pajtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

4.10.1.1. Komisioni për Çështje Normative

Bazuar në ligj, Komisioni për Çështje Normative është themeluar me vendim të Këshillit KPK/nr. 49/2016 në përbërje prej tre anëtarësh, ku gjatë vitit 2019 është ndryshuar Kryesuesi dhe një anëtar i këtij komisioni. Fushëveprimtaria e Komisionit është rregulluar me Rregulloren nr. 08/2015 për Komisionin për Çështje Normative.

Gjatë vitit 2019, Komisioni ka mbajtur takime të shumta, ku përveç anëtarëve të Komisionit kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga organizatat ndërkombëtare që

mbështesin punën e Komisionit dhe të sistemit prokurorial në përgjithësi. Po ashtu, takimet e Komisionit janë mbështetur nga Sekretariati i Këshillit.

Gjatë vitit 2019, Komisioni ka hartuar dhe trajtuar këto akte ligjore dhe nënligjore:

- Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr.08.2016 për emërimin e kryeprokurorëve;
- Rregulloren për administrimin dhe ndarjen e lëndëve në Prokurorin e Shtetit;
- Rregulloren për Shërbimin e Komunikimit Publik në sistemin prokurorial;
- Rregulloren për procedurën e ndërmjetësimit të rasteve nga prokuroria;
- Rregulloren për procedurën disiplinore të prokurorëve;
- Rregulloren për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe kryeprokurorëve të prokurorive të Republikës së Kosovës.

Përveç këtyre, Komisioni ka ofruar opinione ligjore sipas kërkesave të Këshillit.

Gjatë vitit 2019, Komisioni ka vazhduar me praktikën e takimeve të përbashkëta me komisionet përhershme dhe trupat ndihmëse të Këshillit me qëllim të avancimit në procesin e hartimit të akteve nënligjore të Këshillit, përmes propozimeve për plotësimndryshim të akteve ekzistuese si dhe hartimin e akteve të tjera që këto komisione i vlerësojnë të nevojshme gjatë realizimit të mandatit të tyre.

Përveç takimeve të Komisionit, Kryesuesi i Komisionit ka mbajtur takime të veçanta edhe me përfaqësues të organizatave të brendshme dhe të jashtme, ku janë diskutuar çështje nga fushëveprimtaria e Komisionit për Çështje Normative.

4.10.1.2. Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel

Me Vendimin nr. 54/2016 të Këshillit është themeluar Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel me përbërje prej tre anëtarësh. Përgjegjësitë e komisionit janë të përcaktuara me Rregulloren nr.05/2017 për Komisionin për Buxhet, Financa dhe Personel. Komisioni ka hartuar Planin e punës për vitin 2019 dhe në bazë të të cilit ka realizuar aktivitetet e planifikuara me qëllim të zbatimit të përgjegjësive të përcaktuara me rregullore.

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel gjatë vitit 2019 ka realizuar dhjetë (10) takime pune ku ka shqyrtuar dhe miratuar: Raportin financiar për vitin 2018, Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2020 dhe Vlerësimet e hershme 2021–2022, raportet financiar për periudha tremujore dhe rekrutimin e stafit, Kërkesën buxhetore 2020 dhe Vlerësimet e hershme 2021 – 2022, ku janë paraqitur rritja e numrit të prokurorëve dhe nëpunësve civilë, si dhe rritja në kategoritë paga dhe mëditje dhe mallra dhe shërbime, rishikimin e Kërkesës buxhetore 2019-2021, realizimin e buxhetit të sistemit prokurorial, duke përfshirë të gjitha programet buxhetore të Këshillit sipas kategorive ekonomike, me fokus të veçantë në zbatimin

e projekteve kapitale sipas planifikimit për këtë vit dhe nevojave të prokurorive.

4.10.1.3. Procedurat disiplinore

Procedurat hetimore dhe disiplinore deri në qershor të vitit 2019, përkatësisht, para hyrjes në fuqi të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve janë zhvilluar nga Komisioni Disiplinor si komision i përhershëm i Këshillit.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Këshilli ka miratuar listën me emrat e tridhjetë (30) prokurorëve, që do të shërbejnë në panelet hetimore lidhur me procedurën disiplinore të prokurorëve.

Andaj, gjatë vitit 2019, Këshilli ka zhvilluar procedurat disiplinore përmes Komisionit Disiplinor dhe paneleve hetimore dhe ka shqiptuar këto masa disiplinore ndaj prokurorëve të cilat kanë marrë formën përfundimtare:

- 1 pushim të procedurave;
- 1 propozim për largim nga detyra e PSH-së (që me dekret të Presidentit është larguar nga detyra e PSH-së);
- 1 ulje në detyrë brenda sistemit prokurorial;
- 1 qortim;
- 2 refuzime të raporteve përfundimtare;
- 2 vendime “Nuk ka kryer shkelje”;
- 1 transferim të përhershëm nga pozita e prokurorit nga DKR në DP;
- 3 vërejtje jopublike me shkrim.

Përveç këtyre, Këshilli ka marrë edhe 2 vendime të tjera disiplinore, por të cilat pritet të bëhen përfundimtare pas kalimit të afatit të ankesës. Këto vendime janë:

- 1 zvogëlim i përkohshëm i pagës për 30% për një periudhë 6 muajore dhe
- 1 zvogëlim i përkohshëm i pagës për 50% për një periudhë 1 vjeçare.

Në proces e sipër janë duke u zhvilluar procedura disiplinore edhe për 4 raste të tjera.

4.10.1.4. Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve

Këshilli ka themeluar Komisionin për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve më 18 shkurt 2016.

Komisioni gjatë vitit 2019 ka realizuar nëntëdhjetë (90) vlerësime të performancës së prokurorëve, prej tyre 88 kanë qenë të planifikuara me planin e veprimit, ndërsa

dy (2) vlerësime kanë qenë të jashtëzakonshme sipas vendimit të Këshillit. Për më tej, komisioni gjatë vitit 2019 ka mbajtur katërdhjetë (40) takime pune dhe ka realizuar njëzetegjashtë (26) vizita pune nëpër prokuroritë respektive.

Nga tërësia e vlerësimeve të finalizuara gjatë vitit 2019, Komisioni, sipas mandateve, ka realizuar performancën e prokurorëve, si në vijim:

Dyzet e gjashtë (46) prokurorë me mandat të përhershëm, të cilët janë vlerësuar për periudhën trevjeçare, prej të cilëve:

- Dyzet e katër (44), në vlerësim të rregullt, *ndërsa*
- Dy (2) prokurorë në vlerësim të jashtëzakonshëm.

a. Dyzet e katër (44), prokurorë me mandat fillestar, të cilët janë vlerësuar për periudhën dhjetë (10) mujore, prej të cilëve:


- Njëzetedy (22) prokurorë me vlerësimin e parë të performancës dhjetëmujore (*nga muaji i 13-të nga dekretimi deri në muajin e 22-të*) dhe
- Njëzetedy (22) prokurorë me vlerësimin e dytë të performancës dhjetëmujore (*nga muaji i 23-të nga dekretimi deri në muajin e 32-të*);

Komisioni, përmes nëntë (9) proceseve ka vlerësuar performancën e nëntëdhjetë (90) prokurorëve, të cilët, sipas niveleve, janë vlerësuar si në vijim:

- Shumë mirë janë vlerësuar pesëdhjetenëntë (59) prokurorë, apo 66.56%;
- Mirë janë vlerësuar njëzeteshtatë (27) prokurorë, apo 30%;
- Mjaftueshëm janë vlerësuar dy (2) prokurorë, apo 2.22%;
- Pamjaftueshëm janë vlerësuar dy (2) prokurorë, apo 2.22%;

Tabela nr. 1 Procesi i vlerësimit

Proceset	Nunmri i prokurorëve	Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Pamjaftueshëm
Procesi I	8	8			
Procesi II	13	11	2		
Procesi III	1				1
Procesi IV	13	7	5	1	
Procesi V	1				1
Procesi VI	2	1	1		
Procesi VII	22	12	10		
Procesi VIII	10	6	3	1	
Procesi IX	20	14	6		
Gjithsej:	90	59	27	2	2



Grafikoni 1. Vlerësimi

Sipas kronologjisë së proceseve të vlerësimit dhe niveleve vlerësuese, Komisioni ka vlerësuar nëntëdhjetë (90) prokurorë, si në vijim:

- I. Në procesin e parë, Komisioni ka vlerësuar performancën e tetë (8) prokurorëve me mandat të përhershëm dhe të gjithë (100%) janë vlerësuar me nivelin: Shumë mirë.

- II. Në procesin e dytë, Komisioni ka vlerësuar performancën e trembëdhjetë (13) prokurorëve me mandat të përhershëm, prej të cilëve:
- Njëmbëdhjetë (11) prokurorë (*apo 84.62%*) me nivelin: Shumë mirë;
 - Dy (2) prokurorë (*apo 15.38%*) me nivelin: Mirë.
- III. Në procesin e tretë, Komisioni ka realizuar vlerësimin e jashtëzakonshëm të performancës së një (1) prokurori të shtetit, të cilin e ka vlerësuar me nivelin pamjaftueshëm dhe për këtë vlerësim ka raportuar në Këshill.
- IV. Në procesin e katërt, Komisioni ka vlerësuar performancën e trembëdhjetë (13), prokurorëve me mandat të përhershëm, prej të cilëve:
- Shtatë (7) prokurorë (*apo 53.85%*) me nivelin: Shumë mirë;
 - Pesë (5) prokurorë (*apo 38.46%*) me nivelin: Mirë;
 - Një (1) prokuror (*apo 7.69%*) me nivelin: Mjaftueshëm, dhe për pasojë të këtij vlerësimi komisioni i ka propozuar Këshillit që të njëjtin ta obligojë me masën "Trajnim të detyrueshëm".
- V. Në procesin e pestë, Komisioni ka realizuar vlerësimin e jashtëzakonshëm të performancës së një (1) prokurori të shtetit, të cilin e ka vlerësuar me nivelin pamjaftueshëm dhe për këtë vlerësim ka raportuar në Këshill.
- VI. Në procesin e gjashtë, Komisioni ka vlerësuar performancën e parë dhjetëmujore të dy prokurorëve me mandat fillestar, prej të cilëve:
- Një (1) prokuror (*apo 50%*) me nivelin: Shumë mirë;
 - Një (1) prokuror (*apo 50%*) me nivelin: Mirë.
- VII. Në procesin e shtatë, Komisioni ka vlerësuar performancën e dytë dhjetëmujore të njëzetedy (22) prokurorëve me mandat fillestar, prej të cilëve:
- Dymbëdhjetë (12) prokurorë (*apo 54.55%*) me nivelin: Shumë mirë;
 - Dhjetë (10) prokurorë (*apo 45.54%*) me nivelin: Mirë.
- VIII. Në procesin e tetë, Komisioni ka vlerësuar performancën e dhjetë (10) prokurorëve me mandat të përhershëm, prej të cilëve:
- Gjashtë (6) prokurorë (*apo 60%*) me nivelin: Shumë mirë;

- Tre (3) prokurorë (*apo 30%*) me nivelin: Mirë.
- Një (1) prokuror (*apo 10%*) me nivelin: Mjaftueshëm, dhe për pasojë të këtij vlerësimi, Komisioni i ka propozuar Këshillit që të njëjtin ta obligoj me masën “Trajnim të detyrueshëm”;

IX. Në procesin e nëntë, Komisioni ka vlerësuar performancën e parë dhjetëmuajore të prokurorëve me mandat të përhershëm, prej të cilëve:

- Katërbëdhjetë (14) prokurorë (*apo 63.63%*) me nivelin: Shumë mirë;
- Gjashtë (6) prokurorë (*apo 27.27%*) me nivelin: Mirë.

4.10.1.5. Komisioni për Administrimin e Prokurorive

Komisioni për Administrimin e Prokurorive është themeluar më 29 mars 2017 me vendim të Këshillit. Përgjegjësitë, kompetencat dhe mënyra e punës së Komisionit janë përcaktuar me Rregulloren nr. 03.2017 për Komisionin për Administrimin e Prokurorive, sipas të cilës, ndër përgjegjësitë më kryesore janë: përgatitja dhe rekomandimi i politikave për administrimin e prokurorive, menaxhimin e rrjedhës së lëndëve, përfshirë atë elektronik, inspektimin e mbajtjes së regjistrave, menaxhimin e objekteve dhe pasurisë së prokurorive dhe adresimin e çështjeve të tjera për administrim të prokurorive.

Komisioni gjatë vitit 2019 ka mbajtur takime, në të cilat janë diskutuar gjendja e regjistrave, mënyra e regjistrimit të lëndëve, mbajtja e shënimeve statistikore dhe harmonizimi i raportimit të prokurorive, gjendja e përgjithshme e objekteve të PSH-së dhe shkalla e funksionalitetit dhe saktësia e shënimeve statistikore në Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve, duke përfshirë monitorimin e zbatimit. Mbikëqyrja e këtyre proceseve është realizuar nga vizitat në teren dhe krahasimi i raporteve të pranuar bazuar në planin e punës së Komisionit të miratuar për vitin 2019.

Në mbështetje të Komisionit, Njësitë për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë ka hartuar raporte analitike dhe krahasimore për ngarkesën me lëndë dhe saktësinë statistikore duke krahasuar të dhënat e gjeneruara nga shkrimoret dhe prokurorët. si dhe krahasimin me SMIL. Mbi bazën e këtyre raporteve dhe diskutimeve të Komisionit janë përgatitur rekomandimet adekuate për Këshillin ku gjatë vitit 2019 janë realizuar transferime dhe avancime të prokurorëve.

Anëtarët e Komisionit dhe zyrtarët e Njësitit dhe Sekretariatit në mbështetje të Komisionit kanë realizuar vizita në prokuroritë themelore në Pejë, Gjakovë dhe Prizren, me ç'rast janë realizuar takime dhe diskutime me udhëheqësit e prokurorive lidhur me mbajtjen e shënimeve në regjistra, harmonizimit të raportimit të punës së prokurorive dhe unifikimin e praktikës së punës.

4.10.2. Komisionet ad hoc

Duke u bazuar në ligjin për themelimin e tij, Këshilli themelon edhe komisionet ad hoc me qëllim të realizimit të aktiviteteve specifike, ku me vendim përkatës përcakton përbërjen dhe fushëveprimtarinë e tyre.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2019, kanë funksionuar këto komisione ad hoc:

4.10.2.1. Komisioni për Rekrutim

Këshilli themeloi Komisionin për Rekrutim më 7 shtator 2018, i cili vazhdoi punën deri në dekretimin e prokurorëve të rinj në maj 2019 në këtë përbërje: Kryeprokurori i Shtetit - Kryesues dhe katër anëtarë, ndërsa anëtarë rezervë - dy prokurorë. Ky Komision në mandat kishte përgatitjen e Testit kualifikues, Testit me shkrim dhe Intervistës me gojë për kandidatët për prokurorë, kontrollimin e rezultateve të testimit dhe vlerësimin e intervistës me gojë.

4.10.2.2. Komisioni për Rishqyrtim

Këshilli themeloi Komisionin për Rishqyrtim më 7 shtator 2018, i cili vazhdoi punën deri në dekretimin e prokurorëve të rinj në maj 2019 në përbërje: Kryesuesi i Këshillit në rolin e kryesuesit të Komisionit për Rishqyrtim, dy anëtarë të rregullt dhe tre anëtarë rezervë me mandat për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve për prokurorë. Pas shqyrtimit të ankesave, të gjithë kandidatët janë njoftuar me shkrim lidhur me vendimet e komisionit.

4.10.2.3. Komisioni për Transferim dhe Avancim

Këshilli rithemeloj Komisionin për Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit gjatë vitit 2019 në përbërje: Kryeprokurori i Shtetit në rolin e kryesuesit, dy anëtarë të rregullt dhe tre (3) anëtarë rezervë.

Ky komision gjatë vitit 2019 ka realizuar gjashtë (6) procese të avancimit të prokurorëve në prokuroritë themelore.

Gjatë kësaj periudhe janë transferuar katër prokurorë nga një departament në tjetrin të prokurorive themelore.

4.10.2.4. Panelet vlerësuese për proceset e emërimit të kryeprokurorëve

Më 3 shtator 2019, Këshilli, pas tërheqjes së shortit, ka aprovuar përbërjen e Paneleve vlerësuese për proceset e emërimit të Kryeprokurorit të PSRK-së dhe Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, në përbërje nga Kryesuesi dhe anëtarët e Këshilli Prokurorial të Kosovës: Kryesuesi i Këshillit në rolin e kryesuesit, katër anëtarë të rregullt dhe dy anëtarë rezervë.

4.10.2.5. Komisionet për rishqyrtim për proceset e emërimit të kryeprokurorëve

Më 3 shtator 2019, Këshilli, pas tërheqjes së shortit, ka aprovuar përbërjen e Komisioneve për rishqyrtimin e kundërshtimeve për proceset e emërimit të Kryeprokurorit të PSRK-së dhe Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore të Prishtinës në përbërje prej tre anëtarëve të Këshillit.

4.10.2.6. Grupi punues për monitorim të zbatimit të Planit strategjik të sistemit prokurorial 2019-2021

Pas miratimi të Planit strategjik të sistemit prokurorial 2019 – 2021, Këshilli, në prill të vitit 2019, themeloi grupin punues për monitorimin e këtij plani, në përbërje prej tre anëtarësh: një anëtar i Këshillit, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit dhe Drejtori i Njësitit.

4.10.2.7. Grupi punues për zbatim të detyrave specifike që dalin nga Plani strategjik i sistemit prokurorial 2019-2021

Pas miratimi të Planit strategjik të sistemit prokurorial 2019 – 2021, Këshilli, në prill të vitit 2019, themeloi grupin punues për zbatim të detyrave specifike që dalin nga ky plan, në përbërje prej tre anëtarësh: një anëtar i Këshillit, një prokuror nga ZKPSH-ja dhe një anëtar nga Njësi.

4.10.2.8. Grupi punues për mbikëqyrjen e Njësitit për luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike që del nga Plani strategjik i sistemit prokurorial 2019-2021

Pas miratimi të Planit strategjik të sistemit prokurorial 2019 – 2021, Këshilli, në prill të vitit 2019, themeloi grupin punues për mbikëqyrjen e Njësitit për luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike, në përbërje prej tre anëtarësh: Zëvendëskryesuesi i Këshillit, një prokuror nga ZKPSH-ja dhe Kryeprokurori i Apelit.

Ky grup punues ka mbikëqyrur punën e prokurorive themelore për trajtimin dhe zgjidhjen më të shpejtë të lëndëve të pazgjidhura të veprave penale të korrupsionit dhe krimeve ekonomike, për të cilën ka raportuar para Këshillit lidhur me të gjitha konstatimet për të gjeturat dhe rekomandimet konkrete.

III. PJESA E TRETË

5. Buxheti i Këshillit

Këshilli menaxhon buxhetin vjetor për Këshillin dhe prokuroritë në mënyrë të pavarur dhe mban përgjegjësi për mbikëqyrjen e shpenzimeve, alokimin e fondeve, mirëmbajtjen e llogarive të sakta dhe aktuale, si dhe auditimin financiar.

Bazuar në Ligjin nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, Këshillit i janë ndarë 14,170,065.00€. Buxheti i vitit 2019 është më i lartë për 3,077,239.00€ sesa buxheti i vitit 2018.

Në kuadër të kategorive ekonomike të buxhetit të Këshillit përfshihen: pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, shpenzimet komunale dhe shpenzimet kapitale.

Këshilli ka katër programe buxhetore: prokurorët dhe administrata ku përfshihen të gjitha shpenzimet e krijuara nga Këshilli dhe PSH-ja, prokurorët specialë, Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave dhe Njësia Kundër Krimeve Ekonomike.

Gjatë këtij viti janë bërë ndryshime në kuadër të buxhetit të Këshillit, si rrjedhojë e mjeteve shtesë, transfereve, harmonizimit brenda programeve buxhetore dhe kursimeve të deklaruara dhe si rezultat i kësaj krijohet ndryshimi mes buxhetit fillestar dhe përfundimtar, përmes:

1. Vendimit të Qeverisë nr.04/91 të datës 26.02.2019, me të cilin është miratuar kërkesa e KPK-së për shtesat e rrezikshmërisë së prokurorëve dhe shërbyesve civilë të programit 322, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, ka ndikuar në rritjen e kategorisë së pagave dhe mëditjeve për 171,864.00€.
2. Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 06/L - 057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, përgjegjësitë disiplinore janë ndarë për gjyqtarë të KGJK-ja dhe për prokurorë të KPK-ja. Sipas këtij ligji, stafi dhe buxheti i ZPD-së ndahen për KGJK-në dhe KPK-në. Me këtë rast janë transferuar 8 zyrtarë nga KGJK-ja në KPK dhe buxheti në vlerë prej 28,889.20€ i ndarë në dy programe dhe tri kategori ekonomike, si në vijim:
 - Prokuroritë dhe administrata
 - a. 7 pozita;
 - b. 16,403.40€ në kategorinë paga dhe mëditje;
 - c. 7,930.00€ në kategorinë mallra dhe shërbime, si dhe
 - d. 418.00€ në kategorinë shërbime komunale.
 - Prokuroria Speciale
 - e. 1 pozitë;
 - f. 2,050.80€ në kategorinë paga dhe mëditje;
 - g. 1,982.60€ në kategorinë mallra dhe shërbime, si dhe

h. 104.40€ në kategorinë shërbime komunale.

3. Vendimit të Qeverisë nr.02/113 të datës 5.11 2019, me të cilin është miratuar kërkesa për transferim të mjeteve nga kategoria e shërbimeve komunale të programit 322 Prokuroria Speciale në kategorinë e njëjtë të programit 330 Njësia për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave me vlerë prej 1,200.00€, si dhe kursimet në investimet kapitale me vlerë prej 199,016.00€.
4. Vendimit të Qeverisë nr.03/115 të datës 17.12.2019, me të cilin janë paraqitur kursimet sipas programeve dhe kategorive ekonomike dhe atë:
 - a. 63,500.00€ kursime në kategorinë mallra dhe shërbime,
 - b. 47,000.00€ kursime në kategorinë shërbime komunale, si dhe
 - c. 547,300.00€ kursime në kategorinë e investimeve kapitale;
 - d. 504,590.22€ janë ndarë për mbulimin e pagave të muajit dhjetor.

Tabela nr. 2. Buxheti i Këshillit dhe ndryshimet gjatë vitit

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti përfundimtar	Ndryshimi	% e shperndarjes së buxhetit në kategori
Paga dhe Mëditje	9,715,383	10,410,291	694,908	74.26
Mallra dhe Shërbime	2,470,552	2,416,965	(53,587)	17.24
Shpenzime Komunale	199,630	153,152	(46,478)	1.09
Investime Kapitale	1,784,500	1,038,184	(746,316)	7.41
Totali	14,170,065	14,018,592	(151,473)	100


Tabela nr. 3. Buxheti sipas programeve buxhetore

Kategoritë ekonomike	Prokuroritë dhe Administrata		Prokuroria Speciale		Njësia për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave		Njësia Kundër Krimeve Ekonomike	
	Buxheti Fillestar	Buxheti Përfundimtar	Buxheti Fillestar	Buxheti Përfundimtar	Buxheti Fillestar	Buxheti Përfundimtar	Buxheti Fillestar	Buxheti Përfundimtar
Paga dhe Mëditje	8,396,366	9,057,227	1,060,828	1,081,677	224,589	255,689	33,600	15,698
Mallra dhe Shërbime	2,256,370	2,214,300	131,532	130,515	51,978	50,978	30,672	21,172
Shërbime Komunale	152,630	123,048	45,300	27,204	1,700	2,900		
Investime kapitale	1,610,196	863,880	174,304	174,304	-	-		
Totali	12,415,562	12,258,455	1,411,964	1,413,700	278,267	309,567	64,272	36,870

Në tabelën në vijim paraqitet buxheti fillestar, përfundimtar dhe realizimi i buxhetit sipas kategorive ekonomike.

Tabela nr. 4. Realizimi i buxhetit janar-dhjetor 2019

Përshkrimi	Buxheti përfundimtar	Realizimi i buxhetit	Realizimi i buxhetit në %
Paga dhe Mëditje	10,410,291	10,410,291	100.00%
Mallra dhe Shërbime	2,416,965	2,243,166	92.81%
Shpenzime Komunale	153,152	131,254	85.70%
Investime Kapitale	1,038,184	930,049	89.58%
Totali	14,018,592	13,714,760	97.83%



Grafikoni 2: Realizimi i buxhetit

Realizimi i buxhetit për vitin 2019 është 97.83% ku në secilën kategori ekonomike përqindja e shpenzimit është rreth 90%-100%.

5.1. Realizimi i buxhetit janar - dhjetor 2019

Me qëllim të prezantimit të informatave të ndryshme më poshtë janë të paraqitura informatat detaje të shpenzimeve për secilën kategori të shpenzimeve në formë përshkruese, në formë tabelore dhe me paraqitje të grafikoneve për 4 programet buxhetore të Këshillit.

5.2. Paga dhe mëditje


Buxheti fillestar në kategorinë e pagave dhe mëditjeve është 9,715,383.00€ dhe është më i lartë sesa buxheti i vitit 2018 për 2,477,239.00€. Realizimi i buxhetit në këtë kategori është 10,410,291 apo %100 e buxhetit.

Në tabelën në vijim janë pasqyruar shpenzimet sipas programeve buxhetore.

Tabela 5: Pagat dhe mëditjet

Përshkrimi	Prokuroritë dhe Administrata	Prokuroria Speciale	Njësia për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave	Njësia Kundër Krimeve Ekonomike	Totali
Pagat neto	7,550,396	895,060	216,771	12,782	8,675,009
Sindikata	12,034	2,981	226		15,240
Tatimi	637,458	81,260	14,381	1,420	734,519
Kontributi i punëmarrësit	428,670	51,188	12,156	748	492,761
Kontributi i punëdhënësit	428,670	51,188	12,156	748	492,761
Totali	9,057,227	1,081,677	255,689	15,698	10,410,291

Përmes grafikoni pasqyrohen shpenzimet për kategorinë e pagave dhe mëditjeve për të gjitha programet buxhetore të Këshillit.



Grafikoni 3: Shpenzimi i pagave dhe mëditjeve

Gjatë vitit 2019 janë mbuluar të gjitha shpenzimet e krijuara me përjashtim të shtesave të stafit administrativ për muajin dhjetor që mbesin si obligime për vitin 2020 në vlerë prej 29,600 eurosh. Nga shuma totale e shpenzimeve në këtë kategori 87% janë shpenzime të programit buxhetor Prokuroritë dhe administrata, 10.39% për Prokurorinë Speciale, 2.46% për Njësinë për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave dhe 0.15% për Njësinë Kundër Krimeve Ekonomike.

5.3. Mallra dhe shërbime

Buxheti fillestar i kategorisë ekonomike për mallra dhe shërbime është 2,470,552.00€. Buxheti i vitit 2019 është më i lartë për 400,000.00€ sesa buxheti i vitit 2018. Rritja e buxhetit është bërë në nënkategorinë e shërbimeve të përfaqësimit dhe mirëmbajtjes së objekteve.

Gjatë vitit 2019, buxheti përfundimtar në raport me buxhetin fillestar ka ndryshuar si rrjedhojë e transferit dhe kursimeve në këtë kategori.

Bazuar në Tabelën nr. 6, në të cilën janë paraqitur shpenzimet sipas kodeve dhe nënkodeve ekonomike dhe programeve buxhetore të Këshillit, vërehet se

shpenzimet janë realizuar sipas planifikimit përkatësisht 93% e buxhetit të kësaj kategorie. Në këto shpenzime nuk janë të përfshira kryesisht shpenzimet e muajit dhjetor, faturat e të cilave do të procedohen për pagesë në muajin janar 2020 në vlerë prej 74,011.73 euro.

Në vijim pasqyrohet buxheti dhe shpenzimet për secilin program buxhetore përmes tabelës dhe grafikontit.

Tabela 6: Shpenzimet sipas programeve dhe kodeve ekonomike në mallra dhe shërbime

Përkrahimi	Kodet ekonomike	Buxheti fillestar	Buxheti përfundimtar	Prokuroritë dhe Administrata	Prokuroria Speciale	Njësia për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave	Njësia Kundër Krimeve Ekonomike	Totali	Totali në % në krahasim me buxhetin përfundimtar
Shpenzimet e udhëtimi brenda vendit	13130	2,000	-	-	-	-	-	-	0
Shpenzimet tjera të udhëimit brenda vendit	13133	7,000	-	-	30	-	-	30	0%
Shpenzimet e udhëimit zyrtar jashtë vendit	13140	5,125	5,826	2,710	3,116	-	-	5,826	100%
Meditjet	13141	90,967	60,266	42,415	8,233	2,121	2,164	54,934	91%
Akomodimi	13142	36,000	36,000	5,645	2,254	610	17,277	25,786	72%
Shpenzime tjera	13143	7,000	7,000	1,411	135	220	185	1,951	28%
Shpenzimet e telefonisë mobile	13320	70,600	70,600	59,590	3,528	2,878	630	66,625	94%
Shpenzimet postare	13330	45,300	54,300	53,504	336	-	-	53,839	99%
Shpenzimet internet	13310	6,100	4,100	3,573	-	-	-	3,573	87%
Kablii optik	13340	12,000	12,000	11,390	-	-	-	11,390	95%
Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	13410	36,000	18,000	15,509	-	1,885	-	17,394	97%
Shërbimet e përfaqësimit dhe Avokaturës	13420	795,646	965,651	927,480	34,370	-	-	961,850	100%
Shërbimet e ndryshme shëndetësore	13430	2,000	2,000	-	-	-	-	-	0%
Shërb. shpëtojë marketing	13450	1,000	1,000	58	-	-	-	58	6%
Shërbime të ndryshme intelektuale	13440	-	-	684	-	-	-	684	0%
Shërbime kontraktuese tjera	13460	26,500	26,500	22,394	-	-	-	22,394	85%
Shpenzimet për anëtarësim	13480	1,000	1,000	-	-	-	-	-	0%
Mobile	13501	50,006	27,319	27,319	-	-	-	27,319	100%
Telefona	13502	6,000	-	-	-	-	-	-	0%
Komputer	13503	5,000	-	-	-	-	-	-	0%
Hardwer	13504	-	-	-	-	-	-	-	0%
Pajisje tjera	13509	40,800	20,800	15,322	18	-	-	15,340	74%
Furnizim për zyrë	13610	119,758	66,359	60,428	5,591	874	-	66,893	101%
Furnizim me ushqim dhe pije	13620	15,500	2,838	2,838	-	-	-	2,838	100%
Furnizim Pastrimi	13640	1,300	-	-	-	-	-	-	0%
Furnizim me veshmbathje	13650	1,500	-	-	-	-	-	-	0%
Naftë për ngrohje qendrore	13720	45,000	58,953	42,887	16,066	-	-	58,953	100%
Derivate për gjeneratorë	13770	1,500	3,953	3,953	-	-	-	3,953	100%
Dru	13760	5,000	1,704	1,704	-	-	-	1,704	100%
Karburant për vetura	13780	120,800	95,019	76,280	10,271	8,469	-	95,019	100%
Regjistrimi i automjeteve	13950	7,970	5,150	4,000	615	535	-	5,150	100%
Sigurimi i automjeteve	13951	24,200	13,984	11,624	1,474	885	-	13,984	100%
Taksa komunale për regjistrim të veturave	13952	840	840	440	70	70	-	580	69%
Sigurimi i ndërtesave	13953	90,000	114,883	114,883	-	-	-	114,883	100%
Mirëmbajtja e veturave	14010	52,150	52,150	30,766	3,219	2,997	-	36,982	71%
Mirëmbajtja e ndërtesave	14020	160,000	121,226	120,700	16	-	-	120,716	100%
Mirëmbajtja e TI	14040	30,000	26,921	4,995	130	-	-	5,125	19%
Mirëmbajtja e mobilieve dhe ndërtesave	14050	6,000	6,000	1,590	36	-	-	1,626	27%
Qiraja për ndërtesa	14110	172,000	177,470	177,470	-	-	-	177,470	100%
Qiraja për pajisje	14130	63,000	63,000	20,191	3,770	1,534	-	25,495	40%
Qiraja për vetura	14140	217,450	217,450	152,093	22,632	4,164	-	178,888	82%
Reklama dhe konkurse	14210	7,000	7,000	-	-	-	-	-	0%
Botime e publikime	14220	9,500	9,500	3,280	-	1,074	-	4,354	46%
Drekat zyrtare	14310	44,260	46,149	36,298	1,438	7,550	279	45,566	99%
Vendimet e gjykatave	14410	-	-	-	-	-	-	-	0%
Tatimi në qira	14510	29,720	13,995	13,995	-	-	-	13,995	100%
Totali		2,470,552	2,416,965	2,069,417	117,347	35,865	20,536	2,243,166	93%

Zvogëlimi i shpenzimeve në këtë kategori vazhdon të mbetet si çështje me më rëndësi për Këshillin. Ndryshimet e Kodit Penal lidhur me rastet e komunikacionit kanë bërë që shpenzimet për ekspertiza për komunikacion të zvogëlohen. Funkcionalizimi dhe zbatimi i SMIL-it pritet dukshëm do të reduktojë shpenzimet e materialit shpenzues gjatë vitit 2020.



Grafkoni 4: Shpenzimet në mallra dhe shërbime

Sipas të dhënave të pasqyruara përmes grafkonit nga shuma totale e shpenzimeve shihet se 92.25% e shpenzimeve janë mbuluar për programin buxhetor Prokuroritë dhe Administrata, 5.23% për Prokurorinë Speciale, 1.60% për Njësinë për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave dhe 0.92% për Njësinë Kundër Krimeve Ekonomike.

5.4. Shpenzimet komunale

Buxheti fillestar i kategorisë ekonomike shërbime komunale është 199,630.00€ dhe është i njëjtë me buxhetin e vitit 2018.

Nga fillimi i vitit 2019, me marrëveshjen e Këshillit me EULEX-in për ndarjen e shpenzimeve të objektit, Këshilli ka marrë përsipër shlyerjen e obligimeve për të gjitha komunalitetë, të cilat deri në janar 2019 i kanë takuar EULEX-it (përveç telefonisë fikse për të cilën shpenzimet i ka bartur gjithmonë Prokuroria Speciale). Për periudhën raportuese, Prokuroria Speciale ka pranuar fatura nga OE KEDS dhe Pastrimi, ndërsa shpenzimet e ujit i mbulon MAP-i.

Gjithashtu, Ministria e Administratës Publike është përgjegjëse për obligimet e shërbimeve komunale (përveç telefonisë fikse) për Prokurorinë e Apelit, Prokurorinë


Themelore në Prishtinë dhe programin Njësia për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, të cilat janë të vendosura në objektin e Pallatit të Drejtësisë.

Në Tabelën nr.7 është paraqitur buxheti i sistemit prokurorial, shpenzimet sipas programeve dhe kodeve ekonomike, si dhe paraqitja e shpenzimeve në përqindje.

Tabela 7 Shpenzimet komunale

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti përfundimtar	Prokuroritë dhe Administrata	Prokuroria Speciale	Njësia për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave	Totali i shpenzimeve	Totali në %
Rryma	111,200	80,000	57,432	20,129		77,561	97%
Uji	11,600	9,000	5,830			5,830	65%
Mbeturina	5,000	5,000	3,834	558		4,392	88%
Ngrohja qendrore	35,600	22,922	11,227	104		11,331	49%
Telefonia fikse	36,230	36,230	26,912	3,546	1,684	32,141	89%
Totali	199,630	153,152	105,234	24,336	1,684	131,254	86%

Përmes grafikoneve prezantohen shpenzimet komunale për nënkategoritë ekonomike.



Grafikoni 5: Shpenzimet komunale

Bazuar në shënimet e lartcekura, buxheti i Këshillit në kategorinë e shërbimeve komunale për vitin 2019 është realizuar 85.70%. Shuma totale e shpenzimeve 80.18% janë të programit buxhetor Prokuroritë dhe Administrata, 18.54% për Prokurorinë Speciale dhe 1.28% për Njësinë për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave. Si obligime të bartura për vitin 2019 janë kryesisht shpenzimet e dhjetorit në vlerë prej 3,697.69 euro.

5.5. Shpenzimet kapitale

Buxheti fillestar për kategorinë e investimeve kapitale për vitin 2019 është 1,784,500.00€, dhe është më i lartë për 200,000.00€ sesa buxheti i vitit 2018.

Bazuar në nenin 9 të Ligjit nr.06/L-133 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, projektet e Këshillit kanë ndryshuar sipas nevojave.

Për periudhën raportuese, Këshilli ka realizuar %90 të buxhetit të ndarë për investime kapitale.

Tabela në vijim paraqet buxhetin fillestar, përfundimtar dhe realizimin e të gjitha projekteve kapitale të miratuara për vitin 2019.

Tabela 8: Projektet kapitale

Emri i projektit	Fondi burimor	Numri i projektit	Buxheti Fillestar	Buxheti përfundimtar	Realizimi	
Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL)	10	18004	67,000	-	-	-
Skeneri i kontrollit dhe Sigurisë	10	18059	150,000	150,000	149,843	100%
Furnizimi dhe instalimi i rafteve lëvizëse për arkiv	10	18064	80,000	35,000	34,347	98%
Furnizimi dhe instalimi me UPS qëndror	10	18065	111,000	54,100	39,530	73%
Renovimi i Ndërtesës së PTH Ferizaji	10	18073	60,000	15,351	15,351	100%
Renovimi i Ndërtesës së PTH Gjilani	10	18076	60,000	8,967	8,967	100%
Renovimi i Ndërtesës së PTH Peja	10	18074	60,000	40,817	40,817	100%
Renovimi i Ndërtesës së PTH Prizren	10	18071	200,000	14,534	14,534	100%
Renovimi i Ndërtesës së PSRK-së	24	18062	660,500	34,196	31,488	92%
Sistemi elektronik për Menaxhimin e Dosjes së Prokurorëve	10	15217	15,000	2,400	2,400	100%
Sistemi elektronik për Menaxhimin e Veturave	10	15218	15,000	2,400	2,400	100%
Furnizimi dhe instalimi i kamerave të sigurisë	10	18081	78,000	78,000	-	-
Salla e konferencave	10	18084	35,000	-	-	-
Furnizim me licenca	10	18085	20,000	20,000	19,050	95%
Pajisjet harduerike dhe softuerike të teknologjisë informative	10	18086	49,000	15,915	15,915	100%
	24	18086	124,000	124,000	123,625	100%
Mjetet e transportit	10	15216	-	268,200	268,200	100%
Renovimi i Prokurorisë Speciale	24	15,591	-	174,304	163,582	94%
Totale			1,784,500	1,038,184	930,049	90%

Ndryshimet mes buxhetit fillestar dhe përfundimtar janë krijuar për arsye të shlyerjes së obligimeve të bartura nga viti 2018, transfereve dhe kursimeve të deklaruara.

5.6. Të hyrat

Bazuar në nenin 230, paragrafi 1.2 të Kodit të Procedurës Penale, nga qershori i vitit 2018 sistemi prokurorial ka filluar të inkasojë të hyra në dobi të fondit për kompensimin e dëmit të viktimave të veprave penale.

Bazuar në raportin e të hyrave për sistemin prokurorial, totali i të hyrave për vitin 2019 është 42,013.21€.

Në vlerën prej 42,013.21 janë të përfshira edhe shitja e veturave me vlerë prej 10,258.00€ (Kontrata nr. 001/2019 e datës 25.03.2019) dhe vlera prej 205.21€ kompensim nga kompensimi i dëmeve nga siguria.

5.7. Donacionet

Edhe gjatë vitit 2019, Këshilli ka gëzuar një përkrahje të vazhdueshme nga donatorë të ndryshëm. Sipas të dhënave të dërguara për këtë vit, aktivitetet e Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit janë mbështetur me një kosto buxhetore të menaxhuar nga donatorët në vlerë prej 284,611 eurosh për shërbime dhe furnizime të ndryshme.

Tabela 9: Donacionet

Shpenzimet nga donatorët	Vlera në euro
EULEX	12,013
AMBASADA AMERIKANE	175,655
TRAJNIME NGA BE-ja	20,864
UNDP	35,573
AMBASADA HOLANDEZE	40,506
TOTALI	284,611

IV. PJESA E KATËRT

6. Bashkëpunimi me institucione dhe organizata të tjera

Këshilli ka vazhduar politikën e bashkëpunimit të hapur dhe profesional me të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Një bashkëpunim ndërinstitucional i veçantë është zhvilluar me institucionet vendore, si me: Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Akademinë e Drejtësisë, Ministrinë e Drejtësisë, Odën e Avokatëve të Kosovës dhe Policinë e Kosovës, ndërsa me institucionet, donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë, bashkëpunimet më të rëndësishme janë zhvilluar me Ambasadën Amerikane, Zyrën e BE-së në Prishtinë, UNDP-në dhe agjencitë e tjera të Kombeve të Bashkuara, Qeverinë e Norvegjisë, EULEX-in, Këshillin e Evropës, IRZ-në, GIZ-in gjerman, etj.

Kryesuesi në emër të Këshillit ka nënshkruar këto marrëveshje bashkëpunimi me institucione vendore dhe ndërkombëtare:

- Marrëveshjen teknike mes Këshillit dhe EULEX-it për modalitetet në lidhje me lokacionin e përbashkët të ish-UNMIK-u në qendër të Prishtinës;
- Memorandumin e mirëkuptimit mes Këshillit dhe Këshillit Gjyqësor lidhur me dhënien në shfrytëzim të objektit të Prokurorisë Themelore në Pejë, Gjykatës Themelore të Pejës, Divizionit për Kundërvajtje;
- Memorandumin e mirëkuptimit mes Këshillit dhe Kolegjit AAB lidhur me krijimin e bashkëpunimit mes KPK-së dhe AAB-së;
- Memorandumin e bashkëpunimit mes Këshillit, Minitrisë së Drejtësisë, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Policisë së Kosovës për funksionalizimin e bazës së integruar të të dhënave për rastet e dhunës në familje;
- Memorandumin e bashkëpunimit mes Këshillit dhe GIZ-it për financimin dhe zbatimin e projektit të Sistemit Elektronik për Menaxhimin e Rasteve në Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave;
- Memorandumin e bashkëpunimit mes Këshillit dhe Grupit për Studime Juridike dhe Politike lidhur me implementimin e projektit “Monitorimi i sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë”;
- Memorandumin e bashkëpunimit mes Këshillit dhe Qendrës për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (CILC) lidhur me implementimin e projektit “Mbështetje për sistemin prokurorial të pavarur, profesional dhe të paanshëm”, të financuar nga Ambasada Holandeze;
- Memorandumin e bashkëpunimit mes Këshillit dhe “Axiom International” lidhur me implementimin e projektit “Forcimi i sistemit të drejtësisë në

Kosovë”, të financuar nga Ambasada Britanike dhe

- Memorandumin e bashkëpunimit mes Këshillit dhe Akademisë së Drejtësisë lidhur me bashkëpunimin në realizim të mandatit ligjor.

Një pjesë e rëndësishme e bashkëpunimit është shprehur edhe në proceset e integritetit evropian, me ç’rast të gjitha kapacitetet e Këshillit janë përgjigjur në çdo kohë kërkesave për raportim.

V. PJESA E PESTË

7. Raporti vjetor i punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2019

Raporti i Vjetor i Punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2019 paraqet punën e Prokurorit të Shtetit, të realizuar gjatë vitit nga të gjitha prokuroritë e Kosovës në të gjitha nivelet. Ky raport është hartuar duke u bazuar në të dhënat statistikore dhe raportet e përgatitura nga prokuroritë, të përpunuara në nivel vendi nga zyrat përkatës në kuadër të sistemit prokurorial.

Raporti ka një strukturë, e cila i mundëson secilit lexues që të orientohet dhe të kuptojë lehtë proceset e punës së Prokurorit të Shtetit dhe të informohet për rezultatet e punës sipas sistemit të punës që aplikojnë prokuroritë, duke i paraqitur ato në mënyrë të thjeshtësuar nga disa këndvështrime, me qëllim që të përcjellën në mënyrë të qartë rezultatet e punës së Prokurorit të Shtetit gjatë vitit 2019.

Në këtë raport, puna e Prokurorit të Shtetit është paraqitur sipas strukturës, si më poshtë:

- Numrin e kallëzimeve - lëndëve penale të bartura nga vitit paraprak, të pranuar, gjithsej në punë dhe të zgjidhura;
- Raporti për parashtruesit e kallëzimeve penale;

7.1. Kallëzimet – lëndët penale në punë nga Prokurori i Shtetit

Prokurori i Shtetit (PSH) gjatë vitit 2019 ka pasur në punë gjithsejtë 166,633 kallëzime – lëndë penale (lëndë nga regjistrat: PP, PPM, PPN, NJN, PPP, lëndët e PA-së dhe ZKPSH-së).

Nga ky numër i lëndëve:

- 111,340 ose 66.81 % janë të trashëguara/bartura si lëndë të pazgjidhura nga vitet paraprake, dhe
- 55,293 ose 33.19 % janë pranuar në punë gjatë vitit 2019.

Gjatë këtij viti, nga ky numër i lëndëve:

- 79,675 se 47.81%² e lëndëve në punë gjatë vitit 2019 janë zgjidhur apo proceduar në organet kompetente dhe
- 86,958 ose 52.19 % e të gjitha lëndëve në punë kanë mbetur pa u zgjidhur.


Efikasiteti i lëndëve të zgjidhura gjatë vitit 2019 është:

- 79,675 kallëzime – lëndë penale janë zgjidhur gjithsej;
- 24,382 kallëzime – lëndë penale më shumë se që janë pranuar gjatë vitit,

2 Në këtë numër të lëndëve të zgjidhura hyjnë edhe lëndët e trashëguara nga vitet paraprake.

apo

- 44.09% kallëzime – lëndë penale më shumë se që janë pranuar gjatë vitit.




Grafikoni 8: Numri i lëndëve të pranuar, të bartura dhe të zgjidhura gjatë vitit 2019

7.2. Lëndët e bartura nga viti 2018 në vitin 2019

Nga viti 2018 në vitin 2019 janë bartur gjithsej 111, 340 lëndë - kallëzime penale në të gjitha departamentet sipas të gjithë regjistrave të prokurorive. Sipas regjistrave, për të gjitha llojet e kallëzimeve - lëndëve penale, gjendja e lëndëve të bartura është si më poshtë:

- 10,323 kallëzime penale të kryesve madhorë (PP) të veprave penale ose 9.28%;
- 1,044 kallëzime penale të kryesve të mitur (PPM) të veprave penale ose 0.94%;
- 80,152 lëndë penale me kryes të panjohur (PPP) të veprave penale ose 71.99%;
- 18,988 lëndë të ndryshme penale (PPN) ose 17.05%;
- 771 lëndë të ndihmës juridike ndërkombëtare (NJNI) ose 0.69%;
- 49 lëndë në Prokurorinë e Apelit (PA) ose 0.04% dhe
- 13 lëndë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH) ose 0.01%.




Grafikoni 9: Kallëzimet- lëndët penale të bartura në vitin 2019

7.3. Lëndët e pranuar në vitin 2019

Gjatë vitit 2019 janë pranuar në punë 55,293 kallëzime – lëndë penale, prej të cilave, sipas regjistrave në Prokurorinë e Shtetit, janë si më poshtë:

- 24,540 kallëzime penale të kryesve madhor (PP) të veprave penale ose 44.38%;
- 2,027 kallëzime penale të kryesve të mitur (PPM) të veprave penale ose 3.67%;
- 10,179 lëndë penale me kryes të panjohur (PPP) të veprave penale ose 18.41%;
- 10,321 lëndë të ndryshme penale (PPN) ose 18.67%;
- 279 lëndë e ndihmës juridike ndërkombëtare (NJNI) ose 0.50%;
- 6,751 lëndë në Prokurorinë e Apelit (PA) ose 12.21% dhe
- 1,196 lëndë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH) ose 2.16%.




Grafikoni 10: Kallëzimet – lëndët penale të pranuar në punë gjatë vitit 2019

7.4. Lëndët e zgjidhura

Në vitin 2019, Prokurori i Shtetit ka pasur një angazhim mjaftë të lartë në punë, si rezultat i të cilës janë kryer një numër mjaft i madh i lëndëve, veçanërisht, në raport me lëndët e pranuar gjatë vitit 2019. Nga gjithsej 79,675 kallëzime – lëndë penale që janë zgjidhur gjithsej, sipas regjistrave të prokurorive përfshirë këtu edhe ZKPSH-në, Prokurorinë e Apelit dhe PSRK-në, pasqyrohet situata si më poshtë:

- 26,479 kallëzime penale të kryesve madhor (PP) të veprave penale ose 33.23%;
- 2,141 kallëzime penale të kryesve të mitur (PPM) të veprave penale ose 2.69%;
- 27,360 lëndë penale me kryes të panjohur (PPP) të veprave penale ose 34.35%;
- 15,603 lëndë të ndryshme penale (PPN) ose 19.58%;
- 233 lëndë e ndihmës juridike ndërkombëtare (NJN) ose 0.29%;
- 6,668 lëndë në Prokurorinë e Apelit (PA) ose 8.37%, dhe
- 1,191 lëndë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH) ose 1.49%.




Grafikoni 11: Kallëzimet - lëndët penale të zgjidhura gjatë vitit 2019

7.5. Lëndët e pazgjidhura

Në fund të vitit 2019, të pazgjidhura kanë mbetur 86,958 kallëzime – lëndë penale, prej të cilave janë:


- 8,384 kallëzime penale të kryesve madhor (PP) të veprave penale ose 9.64%;
- 930 kallëzime penale të kryesve të mitur (PPM) të veprave penale ose 1.07%;
- 62,971 lëndë penale me kryes të panjohur (PPP) të veprave penale ose 72.42%
- 13,706 lëndë të ndryshme penale (PPN) ose 15.76%;
- 817 lëndë e ndihmës juridike ndërkombëtare (NJN) ose 0.94%;
- 132 lëndë në Prokurorinë e Apelit (PA) ose 0.15%, dhe
- 18 lëndë e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH) ose 0.02%;



Grafikoni 12: Kallëzimet- lëndët penale të pazgjidhura në vitin 2019

7.6. Lëndët në punë, të zgjidhura dhe të pazgjidhura

Numri i kallëzimeve – lëndëve penale në punë, të zgjidhura dhe ato të mbetura në fund të vitit 2019, sipas regjistrave, pasqyrohen në grafikonin në vijim.



Grafikoni 13: Kallëzimet – lëndët penale në punë, të zgjidhura dhe të pazgjidhura në 2019


Sipas pasqyrimin në grafikonin 13, numri më i madh i kallzimeve – lëndëve penale në punë i përket:

- Kryesve të panjohur (PPP) të veprave penale me 90,331 ose 54.20%;
- Kryesve madhorë (PP) të veprave penale, me 34,863 ose 20.93%;
- Lëndë të ndryshme penale (PPN) me 29,309 ose 17.59%.
- Lëndët penale të Prokurorisë së Apelit me 6,800 ose 4.08%;
- Kallzimet penale të kryesve të mitur me 3,071 ose 1.85%, dhe
- Lëndët e ZKPSH-së 1,029 ose me 0,62%.
- Lëndët e ndihmës juridike ndërkombëtare (NJNI) 1,050 ose me 0,63%.

Nga ky grafikon shihet se nuk ekziston trendi i njëjtë i numrit të lëndëve që janë në punë sipas llojit dhe atyre të zgjidhura. Përkundër se numri më i madh i lëndëve të zgjidhura është më i madh në regjistrin PPP, megjithatë, ajo nuk reflekton numrin e lëndëve që janë në punë, ngaqë është vetëm %30,29, për dallim prej lëndëve nga regjistri PP, ku shkalla e zgjidhjes së lëndëve është 75,95%.

7.7. Krahasimi i lëndëve të pranuar dhe të zgjidhura mes 2018 dhe 2019

Në grafikonin në vijim pasqyrohet krahasimi i kallzimeve - lëndëve penale (PPP, PPN, PP, PPM), të pranuar dhe të zgjidhura në vitet 2018 - 2019:



Grafikoni 14: Krahasimi i lëndëve të pranuar në punë dhe të zgjidhura 2018–2019 për regjistrat PPP, PPN, PP dhe PPM

Numri i kallëzimeve penale të kryesve madhorë (PP) të pranuar në punë gjatë vitit 2019, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018, *është zvogëluar* për 2,944 kallëzime penale ose 10.71%. Ndërsa numri i kallëzimeve penale të kryesve madhorë (PP) të zgjidhura gjatë vitit 2019, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018, *është zvogëluar* për 3,999 kallëzime penale ose 13.12%.

Numri i kallëzimeve penale të kryesve të mitur (PPM) të pranuar në punë gjatë vitit 2019, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018, *është zvogëluar* për 513 kallëzime penale ose 20.19%. Ndërsa numri i kallëzimeve penale të kryesve të mitur (PPM) të përfunduara gjatë vitit 2019, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018, *është zvogëluar* për 605 kallëzime penale ose 22.03%.


Numri i lëndëve penale të ndryshme (PPN), të pranuar në punë në vitin 2019, krahasuar me vitin 2018, *është zvogëluar* për 1,500 ose për 12.68% të lëndëve. Ndërsa numri i lëndëve penale të ndryshme (PPN), të përfunduara në vitin 2019, krahasuar me vitin 2018, *është zvogëluar* për 1,289 ose për 7.63% të lëndëve.

Numri i lëndëve me kryes të panjohur të veprave penale (PPP), të pranuar në punë gjatë vitit 2019, krahasuar me vitin 2018, *është zvogëluar* për 605 ose 5.61%. Ndërsa numri i lëndëve me kryes të panjohur të veprave penale (PPP), të përfunduara gjatë vitit 2019, krahasuar me vitin 2018, *është rritur* për 10,532 ose 62.58%.

7.8. Trajtimi i rasteve me procedura alternative dhe urdhra ndëshkimorë

Trajtimi i rasteve me procedura alternative synon dhënien e drejtësisë në një kohë sa më të arsyeshme dhe shkarkimin e prokurorëve nga barra e numrit të madh të lëndëve.

Si rezultat i punës, Prokurori i Shtetit ka zgjidhur 6,200 gjatë vitit 2019, prej të cilave 3,799 raste me aktakuzë me urdhër ndëshkimor, 69 raste me 77 persona me pezullim të përkohshëm të procedurës (neni 230), 71 raste me 72 persona sipas kushteve kur ndjekja nuk është e detyrueshme (neni 231), 1,384 raste me 1,800 persona në procedurën e ndërmjetësimi (neni 232), 877 raste me 993 persona me aktakuzë për marrëveshjen e pranimit të fajësisë (neni 233).



Grafikoni 15: Lëndët e zgjidhura me procedura alternative dhe procedura të veçanta

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se nga numri total i rasteve të pranuar (24,461 kallëzime penale - PP në të gjitha prokuroritë themelore) nga Prokurori i Shtetit përmes procedurave alternative³ janë zgjidhur 2,401 raste apo 9.81% me 2,942 persona apo 9.46% të personave. Me urdhër ndëshkimor janë zgjidhur 3,799 persona apo 15.53%.


7.9. Parashtruesit e kallëzimeve penale

Në këtë pjesë do të paraqiten të dhënat lidhur me parashtruesin dhe numrin e parashtruesve të kallëzimeve penale për lëndët, të cilat janë pranuar në punë gjatë vitit 2019.

7.9.1. Parashtruesit e kallëzimeve penale të kryesve madhorë të veprave penale (PP)

Gjatë vitit 2019, prokuroritë themelore dhe PSRK-ja kanë pranuar në punë gjithsej 24,540 kallëzime penale me 31,611 persona madhorë apo në regjistrin PP. Këto kallëzime penale janë parashtruar nga:

³ Rastet e trajtuara me procedurë alternative përfshijnë: nenet 230-233 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.




Grafikoni 16: Parashtruesit e kallëzimeve penale PP

Nga të dhënat statistikore për parashtruesit e kallëzimeve penale, vërehet se numri më i madh i kallëzimeve penale është parashtruar nga Policia e Kosovës me 18,779 kallëzime penale ose 76.52%.

Numri i kallëzimeve - lëndëve penale të kryesve madhor të pranuar në punë gjatë vitit 2019, krahasuar me vitin 2018 **ka shënuar rënie** për 2,944 kallëzime penale ose 10.71%.

7.9.2. Parashtruesit e kallëzimeve penale të kryesve të mitur të veprave penale (PPM)

Departamentet për të mitur (DM-të) të prokurorive themelore në periudhën raportuese kanë pranuar 2,027 kallëzime penale ndaj 2,990 personave të mitur. Këto kallëzime penale janë parashtruar nga:



Grafikoni 17: Parashtruesit e kallëzimeve penale nga PPM

Nga ky grafikon shihet se numri i më i madh i kallëzimeve penale është parashtruar nga Policia e Kosovës me 1,983 kallëzime ose 97.83 % nga të gjitha kallëzimet penale PPM. Numri i kallëzimeve penale të kryesve të mitur, të pranuar në punë gjatë vitit 2019, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, ka shënuar rënie për 513 kallëzime penale ose 20.19%.

7.10. Kallëzimet penale sipas prokurorive

Mbështetur në statistikat për numrin e kallëzimeve penale të pranuar gjatë vitit 2019 në tabelën në vijim pasqyrohet numri i kallëzimeve penale të pranuar për kryesit madhorë (PP), kryesit e mitur (PPM), lëndë të ndryshme penale (PPN) dhe kryesit e panjohur të veprave penale (PPP), sipas kompetencës territoriale të prokurorive themelore dhe PSRK-së.

PTH+PSRK	Regjistri PP		Regjistri PPM		Regjistri PPN		Regjistri PPP		Gjithsej	
	Kallëzimet e pranuar	Nr. i kryerësve	Kallëzimet e pranuar	Nr. i kryerësve	Kallëzimet e pranuar	Nr. i kryerësve	Kallëzimet e pranuar	Nr. i kryerësve	Kallëzimet e pranuar	Nr. i kryerësve
Prishtinë	6,796	8,934	531	767	2,685	NN	4,940	NN	14,952	9,701
Prizren	3,243	4,346	231	374	1,791	NN	920	NN	6,185	4,720
Pejë	3,270	3,863	192	293	1,741	NN	1002	NN	6,205	4,156
Gjakovë	1,905	2,574	130	219	738	NN	483	NN	3,256	2,793
Mitrovicë	4,353	5,174	473	650	573	NN	1,295	NN	6,694	5,824
Gjilan	2,348	2,872	228	342	1,164	NN	565	NN	4,305	3,214
Ferizaj	2,546	3,326	242	345	1,181	NN	920	NN	4,889	3,671
PSRK	79	522	0	0	448	NN	54	NN	581	522
Gjithsej	24,540	31,611	2,027	2,990	10,321	NN	10,179	NN	47,067	34,601

Tabela 2: Kallëzimet - lëndët penale të pranuar për kryesit madhor (PP), kryesit e mitur (PPM), lëndë të ndryshme penale (PPN) dhe kryesit e panjohur (PPP) të veprave penale sipas prokurorive

VI. PJESA E GJASHTË

8. Aktivitetet e Sekretariatit të Këshillit

Sipas Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Sekretariati është njësi e themeluar brenda Këshillit me qëllim të ofrimit të mbështetjes administrative për Këshillin dhe prokuroritë.

Detyrat dhe përgjegjësit e Sekretariatit janë përcaktuar me Ligjin për Këshillin dhe Rregulloren nr. 09/2016 për veprimtarinë dhe organizimin e brendshëm të vendeve të punës në Sekretariatit të Këshillit.

Struktura organizative e Sekretariatit është e organizuar në këtë mënyrë:

- Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm Sekretariatit me këtë përbërje:
 - Auditori i Brendshëm;
 - Zyrtarët Certifikues;
 - Zyra Ligjore;
 - Zyra për Komunikim Publik dhe
 - Zyrtarët administrativë.

- Departamenti për Burime Njerëzore, Prokurim dhe Administratë me këtë përbërje:
 - Divizioni për Burime Njerëzore;
 - Divizioni i Prokurimit;
 - Divizioni i Administratës në kuadër të të cilit funksionojnë:
 - Zyra për Administrim dhe Arkivim;
 - Zyra për Përkthim dhe Lekturim.

- Departamenti për Buxhet, Financa dhe Shërbime të Përgjithshme me këtë përbërje:
 - Divizioni për Buxhet dhe Financa;
 - Divizioni për Shërbime të Përgjithshme, në kuadër të të cilit funksionojnë:

- Zyra për Transport dhe
 - Zyra e Logjistikës dhe Mirëmbajtjes.
- Departamenti për Teknologji Informative me këtë përbërje:
 - Divizioni për Infrastrukturë (Rrjet dhe Server) dhe
 - Divizioni për Sisteme Elektronike (Softuer).

Detyrat dhe përgjegjësit e njësive organizative të Sekretariatit janë përcaktuar me Rregulloren për organizim të brendshëm.

Numri i përgjithshëm i stafit administrativ në sistemin prokurorial në fund të vitit 2019 ka qenë 611.

8.1. Zyra e Drejtorit

Zyra e Drejtorit udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit (Drejtori), i cili është zyrtari kryesor administrativ, me përgjegjësi kryesore për administrimin efikas dhe efektiv të administratës së Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit.

Planifikimi i aktiviteteve, shërbimeve dhe mbështetjes për Këshillin dhe PSH-në janë realizuar nën mbikëqyrjen dhe menaxhimin e drejtpërdrejtë të Drejtorit, përmes strukturës organizative të zyrës së tij dhe Sekretariatit në përgjithësi, duke u bazuar në zbatimin e Planit strategjik 2019-2021 dhe Planit vjetor të punës së Këshillit dhe PSH-së për vitin 2019.

Aktivitetet e Zyrës së Drejtorit gjatë vitit 2019 në përgjithësi janë fokusuar, pa u kufizuar në hartimin e procedurave standarde dhe të veprimit për Zyrën e Certifikimit, hartimin e raporteve të ndryshme (Raporti vjetor i Këshillit dhe PSH-së, raportet e komisioneve të Këshillit, Raporti përmbledhës njëvjeçar i Komisionit për zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave, Raporti përmblyllës i regjistrit nga libri i ekspedicionit për periudhën, etj).

Gjatë vitit 2019 është shënuar angazhim edhe në grupe të ndryshme për hartimin e dokumenteve strategjike të Këshillit, planeve të punës dhe akteve nënligjore të ndryshme. Gjithashtu, Zyra e Drejtorit ka ndihmuar në koordinimin e institucioneve vendore, donatorëve dhe partnerëve të sistemit prokurorial, si dhe ka mbështetur raportimet e ndryshme në proceset e integritimit evropian.

8.1.1. Auditimi i Brendshëm

Sipas detyrave dhe përgjegjësi, Auditori i Brendshëm mbështet menaxhmentin e Këshillit në përmbushjen e objektivave, duke ofruar këshilla dhe rekomandime, me qëllim të përmirësimit të proceseve të punës dhe rritjes së përgjegjshmërisë.

Auditori i Brendshëm është përgjegjës për kryerjen e auditimeve të brendshme të të gjitha njësive organizative dhe programeve buxhetore sipas planit vjetor të auditimit.

Gjatë vitit 2019 janë kryer auditimet e pajtueshmërisë, të cilat kryesisht mbulojnë proceset buxhetore, shpenzimet, të hyrat, paratë e gatshme, menaxhimin e pasurive, të dhënat për pasuritë dhe mirëmbajtjen e tyre, sistemin e prokurimit dhe procedurat që kanë të bëjnë me furnizime dhe shërbime, auditimin e ZMNV-së, si dhe angazhimin e auditimit në Prokurorinë Speciale për të vlerësuar sistemin e kontrollit të brendshëm. Sipas planit vjetor, janë planifikuar dhe realizuar pesë auditime, gjë që reflekton në angazhimin sistematik për përmbushjen e objektivave të njësive me qëllim të funksionimit të organizatës.

Auditimet e realizuara për vitin 2019 janë:

- Auditimi i përfunduar në Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave, me temën: "Funksionimi i sistemit financiar dhe i pasurisë në ZMNV". Në raportin final janë përfshirë gjashtë rekomandime për gjashtë të gjetura;
- Auditimi për Divizionin e Shërbimeve të Përgjithshme, me temën: "Funksionimi i sistemit për shërbimet dhe pasuritë". Në raportin final janë evidentuar tri rekomandime për tri të gjetura;
- Auditimi në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, me temën: "Funksionimi i sistemit për proceset buxhetore, financiare dhe pasuritë". Ky auditim ka rezultuar me gjashtë rekomandime për gjashtë të gjetura;
- Auditimi për Divizionin e Prokurimit, me temën: "Funksionimi i sistemit dhe proceset e prokurimit". Në raportin final janë evidentuar katër rekomandime për katër të gjetura dhe
- Auditimi në Divizionin e Buxhetit dhe Financave, me temën: "Funksionimi i sistemit për proceset buxhetore dhe financiare". Në raportin final janë evidentuar pesë rekomandime për pesë të gjetura.

Të gjitha të gjeturat dhe rekomandimet, paraprakisht ishin trajtuar mirë dhe ishin diskutuar me udhëheqësit e njësive. Sipas verifikimit për zbatimin e rekomandimeve deri në fund të vitit 2019 nga 24 rekomandimet, tetëmbëdhjetë (18) janë zbatuar në tërësi, ndërsa gjashtë (6) rekomandime janë zbatuar pjesërisht dhe janë në proces të zbatimit.

8.1.2. Certifikimi i lëndëve për pagesë

Procesi i certifikimit është procesi i fundit për pagesat e shpenzimeve të krijuara nga aktivitetet e realizuara brenda Këshillit. Gjatë vitit 2019 janë certifikuar 604 lëndë në shumën totale prej 154,636.99 € si obligime të bartura nga viti 2018. Për shpenzimet e krijuara brenda vitit 2019 janë certifikuar 8,951 lëndë në shumën totale prej 154,636.99 €, duke përjashtuar kryesisht faturat e dhjetorit të vitit 2019, të cilat barten si obligime në vitin 2020.

8.1.3. Zyra Ligjore

Zyra Ligjore në kuadër të Zyrës së Drejtorit, gjatë vitit 2019 ka zhvilluar aktivitetet si në vijim:

- Ofrimin e udhëzimeve dhe monitorimin e shërbimeve në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore për Këshillin, komisionet e Këshillit dhe Prokurorin e Shtetit;
- Hartimin e rreth 235 draftakteve nënligjore nga fushëveprimtaria e Këshillit dhe trupave të tjerë, prej të cilave: 13 draftrregullore, nga të cilat 6 të miratuara nga Këshilli, 4 draftudhëzime administrative, që janë në procedurë në Komisionin për Çështje Normative, 3 draftmemorandume të miratuara në Këshill dhe 215 vendime të Këshillit;
- Pjesëmarrjen në 23 përfaqësime ligjore të Këshillit para gjykatave dhe hartimin e 23 përgjigjeve në padi, 2 revizione, 2 prapësime dhe 3 ankesa;
- Kontrollimin e pajtueshmërisë së akteve nënligjore të Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit me Kushtetutën e Kosovës dhe legjislacionin në fuqi në Kosovë;
- Ofrimin e 31 këshillave dhe analizave ligjore për nevojat e Këshillit dhe trupave të tjerë;
- Hartimin e 452 shkresave dhe akteve të ndryshme për nevojat e Zyrës së Drejtorit dhe njësisë organizative të Sekretariatit, përfshirë kontrollin ligjor të tyre, prej të cilave 371 draft vendime dhe 81 draftautorizime dhe
- Angazhimin për çështjet organizative të aktiviteteve të Këshillit dhe Komisionit për Çështje Normative.

8.1.4. Zyra për Komunikim Publik

Gjatë vitit 2019 janë dinamizuar përpjekjet për të zhvilluar një komunikim efikas, transparent dhe të hapur me publikun dhe mediat, me ç'rast takimet e Këshillit kanë vazhduar të jenë të hapura për mediat dhe publikun. Gjitrastu janë ofruar informata me interes për publikun përmes komunikatave, njoftimeve, sqarimeve, ndonjëherë edhe reagimeve dhe materialeve të tjera informuese, siç janë: broshurat, buletinet mujore, etj.

Zyra për Komunikim Publik ka dhënë mendime, këshilla dhe sugjerime lidhur me politikat e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm në Këshill.

Përgjatë vitit janë publikuar vazhdimisht raporte periodike dhe vjetore për punën e Këshillit, komisioneve të tij dhe punën e institucionit të PSH-së, planet vjetore të punës së Këshillit dhe PSH-së.

Në këtë kontekst të dinamizmit dhe orientimit të veprimtarisë së komunikimit publik është vazhduar puna në implementimin e Strategjisë për Komunikim Publik

të sistemit prokurorial 2018-2020, e cila në vetvete ka paraparë aktivitete që do të ndikojnë në rritjen e transparencës në raport me qytetarët.

Më qëllim të unifikimit të informatave në sistemin prokurorial është dizajnuar dhe finalizuar uebportali i këtij sistemi, i cili për dallim nga dy faqet zyrtare - asaj të Këshillit dhe PSH-së, do të sjellë risi në ofrimin më të madh të informatave për qytetarët dhe në shpejtësinë dhe lehtësinë e marrjes së tyre.

Ngritja e transparencës dhe lehtësimi në marrjen e informatave është evidente në secilën prokurori veç e veç, sepse rekrutimi dhe trajnimi i zyrtarëve për komunikim publik ka ndikuar që nëpër të gjitha prokuroritë të ngritet transparenca, përmes publikimit të punëve të tyre, por edhe lehtësimit të marrjes së informatave nga mediat dhe qytetarët.

Gjatë vitin 2019 është intensifikuar bashkëpunimin në fushën e komunikimit me institucionet e tjera me qëllim të koordinimit sa me të mirë në ngritjen e transparencës në raport me publikun.

Thellimi i bashkëpunimit me Zyrën për Komunikim Publik të Policisë së Kosovës dhe gjykatave ka qenë evidente gjatë vitit 2019, ku duhet cekur organizimin e konferencave të përbashkëta për media me Policinë e Kosovës dhe bashkërendimin e ngjarjeve publike me Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Komunikimi me shoqërinë civile ka qenë profesional dhe kërkesat e tyre janë trajtuar në mënyrë profesionale, duke iu kthyer përgjigje me kohë.

Ngritja profesionale e stafit të komunikimit ka qenë objektiv i Zyrës për Komunikim Publik, që ka pasur realizim të kënaqshëm. Janë organizuar trajnime të zyrtarëve për komunikim, po ashtu janë organizuar trajnime të përbashkëta me zyrtarë për komunikim publik të Policisë së Kosovës dhe gjykatave. Janë organizuar punëtori dhe takime me zyrtarët për komunikim publik, administratorë dhe shefa të shkrimoreve të prokurorive, me ç'rast në fokus ishte ngritja e bashkëpunimit dhe komunikimit të brendshëm. Këto punëtori kanë pasur efekt pozitiv në koordinimin dhe bashkëpunimin më të mirë në realizimin e objektivave të komunikimit.

8.2. Departamenti për Burime Njerëzore, Prokurim dhe Administratë

Departamenti për Burime Njerëzore, Prokurim dhe Administratë (DBNJPA), sipas mandatit të përcaktuar në Rregulloren nr.09/2016 për veprimtarinë, organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariatit e Këshillit, renditet në një nga tri shtyllat e Sekretariatit.

Aktivitetet e DBNJPA-së, realizohen përmes:

- ❖ Divizionit për Burime njerëzore,
- ❖ Divizioni për Prokurim dhe
- ❖ Divizionit i administratës i cili përbehet nga:

- ❖ Zyra për Administrimin dhe Arkivimin e Dokumenteve dhe
- ❖ Zyra për Përkthim dhe Lekturim.

Si aktivitete kryesore dhe të përgjithshme në kuadër të DBNJPA-së janë:

- Rekrutimi i personelit administrativ sipas planifikimit;
- Realizimi i transferimeve dhe avancimeve e personelit administrativ bazuar në kërkesat dhe nevojat e sistemit prokurorial;
- Transferimi i 80 pozitave të kategorisë së stafit mbështetës, në nivelin e stafit administrativ, me status të nëpunësit civil;
- Administrimi dhe sistemimi i stafit të transferuar nga ish Zyra e Prokurorit Disiplinor në njësitë organizative të sistemit prokurorial;
- Zbatimi i sistemit elektronik të burimeve njerëzore (SIMBNJ-së). Ky sistem mundëson menaxhimin efikas dhe pasqyrë në kohë reale të të dhënave për të gjithë zyrtarët e administratës së sistemit prokurorial;
- Mbikëqyrja dhe menaxhimi i planit dhe procedurave të prokurimit;
- Implementimi i suksesshëm i sistemit të arkivave;
- Ofrimi i mbështetjes profesionale dhe administrative për panelet hetimore.

8.2.1. Divizioni për Burime Njerëzore

Në ushtrim të funksionit të Divizionit të Burimeve Njerëzore janë zhvilluar një sërë aktiviteteve si në vijim:

Në zbatim të planifikimit si dhe të nevojave për plotësim të pozitave të lira të bartura nga viti paraprak si dhe si pasojë e dorëheqjeve dhe pensionimeve, janë zhvilluar 58 procese rekrutimi.

Në vitin 2019 janë punësuar 62 zyrtarë të rinj të shpërndarë në tërë sistemin prokurorial dhe me qëllim të promovimi të stafit të brendshëm, shtatë (7) zyrtarë janë avancuar në karrierë dhe janë realizuar 3 transferime ndër institucionale. Janë liruar njëzeteshtatë (27) pozita për shkak të pensionimeve, dorëheqjeve, transferimeve etj. Janë anuluar njëmbëdhjete (11) procese të rekrutimit nga Divizioni i Burimeve Njerëzore sipas arsyeve të ndryshme.

Gjatë vitit 2019 është realizuar transferimi i tetë (8) zyrtarëve nga ish-ZPD-së sipas vendimit të Këshillit.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për zyrtarët publikë, në mungesë të akteve nënligjore janë pezulluar gjithsej shpalljet për pozita të lira.

Në pajtim me rregulloren në fuqi me të drejtë ankese janë paraqitur njëzetetete (28) ankesa.

Sipas nevojave dhe kërkesave është hartuar dhe zbatuar plani vjetor i trajnimit për stafin administrativ të sistemit prokurorial.

Janë proceduar pagesat për punë jashtë orari, kujdestari, pagesa retroaktive, punëtorë të rinj, ndryshime në paga, etj.

Në mbështetje të Komisionit Disiplinor të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial, janë pranuar dhe proceduar 10 raste disiplinore, prej tyre pesë (5) kanë qenë refuzime, katër (4) pezullim dhe një (1) ndalim të pagës.

Programi i praktikantëve është program që ka filluar te zbatohet me vite nga Këshilli. Gjatë vitit 2019 ishin njëqindedy (102) praktikantë që vijuan praktikën në të gjitha nivelet e prokurorive.

8.2.2. Divizioni për Prokurim

Sipas Planit të prokurimit për vitin 2019, Divizioni i Prokurimit ka kryer tetëmbëdhjetë (18) procedura të prokurimit në vlerë të mesme dhe të mëdha, nëntë (9) procedura të koutimeve të çmimeve dhe tetë (8) procedura me vlerë minimale, si në vijim:

Procedurat e prokurimit në vlerë të mesme dhe të mëdha janë:

- Sigurimi fizik i objekteve të sistemit prokurorial të Kosovës;
- Shërbime të pastrimit të veturave të sistemit prokurorial të Kosovës;
- Hartimi i projektit dhe mbikëqyrja e ekzekutimit të punëve për objektin e Prokurorisë Speciale të Kosovës;
- Furnizim me pajisje të TI-së për nevojat e sistemit prokurorial të Kosovës;
- Zhvillimi dhe mirëmbajtja e ueportalit të sistemit prokurorial të Kosovës;
- Renovimi i ndërtesës së Prokurorisë Speciale së Kosovës - punë shtesë;
- Mirëmbajtja teknike dhe higjienike e objekteve të sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës;
- Furnizimi, montimi dhe funksionalizimi i pajisjeve për kontroll dhe barriera në objektet e sistemit prokurorial të Kosovës;
- Furnizim me materiale promocional zyrtar të dizajnuar dhe shtypur për nevoja të sistemit prokurorial të Kosovës;
- Furnizimi dhe montimi i mobileve në zyrë për nevoja të sistemit prokurorial të Kosovës;
- Lot 1 - renovimi i disa pjesëve në objektin e PTH Ferizaj dhe Lot 2 - renovimi i disa pjesëve në objektin e PTH Gjilan;
- Lot 1 - renovimi i disa pjesëve në objektin e Prokurorisë Themelore në

Pejë, Lot 2 - renovimi i disa pjesëve në objektin e Prokurorisë Themelore në Prizren;

- Furnizimi dhe vendosja (montimi) i rafteve lëvizëse për arkivat e sistemit prokurorial të Kosovës;
- Furnizimi dhe montimi me tepihë dhe tepisona në objektet e sistemit prokurorial të Kosovës;
- Furnizimi, montimi dhe funksionalizimi me UPS qendror në objektin e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorisë Themelore në Prizren;
- Shërbim me internet dhe VPN (backup) për nevojat e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës;
- Furnizim me pajisje të ndryshme për zyra për nevojat e sistemit prokurorial të Kosovës
- Mirëmbajtja dhe servisimi i veturave të sistemit prokurorial të Kosovës.

Procedurat e prokurimit të kuotimeve të çmimeve

- Furnizimi, montimi dhe funksionalizimi i plotë i pjesëve për 5 ashensorë në objektet e sistemit prokurorial të Kosovës;
- Mirëmbajtja e vulave të sistemit prokurorial të Kosovës;
- Sigurimi i automjeteve të sistemit prokurorial të Kosovës;
- Furnizim me pelet për Prokurorinë Themelore në Mitrovicë;
- Organizimi i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të stafit të Departamentit të TI-së në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Kontrollimi teknik i ashensorëve në objektet e sistemit prokurorial të Kosovës;
- Furnizim me licencë të pajisjeve të TI-së për nevojat e sistemit prokurorial;
- Furnizimi dhe montimi i perdeve në objektet e sistemit prokurorial të Kosovës;
- Furnizimi me telefona fiksë dhe mobilë për kujdestari për nevojat e sistemit prokurorial të Kosovës.

Procedurat e prokurimit për vlerat minimale ishin:

- Shërbime me qera të LED ekran P4 për nevojat e Konferencës vjetore të prokurorëve;
- Furnizim me drunj dekorativë dhe lule për oborrin e objektit të Këshillit

Prokurorial të Republikës së Kosovës;

- Shërbime të rregullimit të pajisjeve të sistemit të ftohjes në Prokurorinë Themelore në Gjilan;
- Demolimin e mureve në Pallatin e Drejtësisë, Objekti C;
- Furnizimi dhe instalimi i Panik Buton në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit;
- Furnizim me medalje me logo të KPK-së dhe PSH-së;
- Shërbime me qira të LED ekran P4 për nevojat e Javës së Viktimave të Krimit;
- Furnizim dhe montim të panos me gjithë mekanizimin lëvizës dhe elemente përcjellëse për funksionalizim të plotë për nevoja të objektit në PTH Gjilan.

8.2.3. Divizioni i Administratës

Në zbatim të Planit për vitin 2019, Divizioni i Administratës ka realizuar aktivitetet në kuadër të Zyrës për Administrim dhe Arkivim dhe Zyrës për Përkthim dhe Lekturim.

Zyra për Përkthim dhe Lekturim ka realizuar përkthime në gjuhët shqipe, serbe dhe angleze, me ç ‘rast janë përkthyer 4.717 faqe të dokumenteve në gjuhët shqipe-serbe dhe anasjelltas. Po ashtu, kjo zyrë ka realizuar përkthim simultan 329 orë në gjuhën serbe dhe angleze dhe anasjelltas gjatë mbledhjeve të KPK-së, komisioneve të përhershme, intervistave gjatë rekrutimit të stafit administrativ në takimet e Këshillit dhe komisioneve të tij.

Për nevoja të sistemit prokurorial është përgatitur Draftudhëzimi administrativ për përkthim dhe lekturim.

Zyra për Administrimin dhe Arkivimin e Dokumenteve ka administruar dokumente të ndryshme, duke bërë pranimin, kontrollimin, klasifikimin dhe evidentimin e dokumenteve. Gjatë këtij viti janë evidentuar gjithsej 1916 dokumente të ndryshme, nga të cilat 586 janë shkresa hyrëse, 496 shkresa dalëse, 672 vendime dhe 7740 fatura nga operatorët e ndryshëm ekonomik dhe prokuroritë.

Nga hyrja në fuqi e Ligjit për procedurën disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Divizioni për Administratë ka ofruar mbështetje profesionale dhe administrative për dymbëdhjetë (12) panele hetimore të themeluara nga KPK-ja.

8.3. Departamenti për Buxhet, Financa dhe Shërbime të Përgjithshme

Bazuar në Rregulloren nr. 09/2016 për veprimtarinë, organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariatën e Këshillit Prokurorial të Kosovës funksionon edhe Departamenti për Buxhet, Financa dhe Shërbime të Përgjithshme (më tej DBFSHP).

Aktivitetet e DBFSHP-së realizohen përmes:

- ❖ Divizionit për Buxhet dhe Financa dhe
- ❖ Divizionit për Shërbime të Përgjithshme, i cili përbëhet nga:
 - ❖ Zyra për Transport dhe
 - ❖ Zyra e Logjistikës dhe Mirëmbajtjes.

Si aktivitete kryesore dhe të përgjithshme në kuadër të DBFSHP-së janë:

- Vlerësimi i nevojave për gjithë sistemin;
- Përgatitja e draftit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve dhe draftbuxhetit vjetor për vitin 2020 dhe vlerësimet e hershme 2021-2022;
- Menaxhimi dhe mbikëqyrja e buxhetit të vitit 2019;
- Analiza dhe vlerësimi i shpenzimeve dhe buxhetit në baza të rregullta;
- Sigurimi i shërbimeve të përgjithshme për gjithë sistemin prokurorial;
- Sigurimi i zbatimit të projekteve kapitale sipas planifikimeve;
- Përgatitja e draftit të Udhëzimit për menaxhimin e shpenzimeve në sistemin prokurorial
- Përgatitja e draftit të Udhëzimit për siguri;
- Bashkëpunimi dhe koordinimi i aktiviteteve brenda dhe jashtë Këshillit për çështje që lidhen me buxhet, financa dhe shërbime të përgjithshme;
- Koordinimi dhe bashkëpunimi i procesit të auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2018 dhe auditimi i ndërmjetëm për vitin 2019 etj.

Vlen të theksohet se te raporti final i auditimit për pasqyrat financiare të vitit 2018, opinionin është i pamodifikuar që do të thotë se pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. Krahasuar me vitet e kaluara, ky është njeri ndër raportet më të mira të Këshillit me vetëm dy të gjetura.

8.3.1. Divizioni për Buxhet dhe Financa

Në kuadër të Divizionit për Buxhet dhe Financa janë realizuar aktivitete që kanë të bëjnë kryesisht me planifikimin e buxhetit dhe menaxhimin e financave për gjithë sistemin prokurorial.

Ndër aktivitetet me më rëndësi në fushën e buxhetit dhe financave përfshihen:

- Përgatitja e planifikimeve buxhetore;
- Përgatitja e rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2019;

- Zbatimi i buxhetit sipas planifikimeve;
- Përgatitja e raporteve financiare;
- Zotimi, shpenzimi dhe regjistrimi i mjeteve buxhetore sipas planifikimeve;
- Regjistrimi i të hyrave;
- Përgatitja e kërkesave të ndryshme për ndryshimin dhe harmonizimin e buxhetit brenda programeve buxhetore dhe kategorive ekonomike;
- Raportimet e rregullta;
- Barazimi i shpenzimeve;
- Zbatimi i rekomandimeve të auditimit etj.

8.3.2. Divizioni për Shërbime të Përgjithshme

Divizioni për Shërbime të Përgjithshme ka realizuar aktivitete të ndryshme që lidhen me furnizime dhe shërbime të ndryshme për gjithë sistemin prokurorial ku me këtë rast janë proceduar:

- 486 lëndë ekzekutive që kanë të bëjnë me kërkesa për zotim, inicim të procedurave dhe shlyerje të detyrimeve;
- 3135 kërkesa të realizuara për furnizime dhe shërbime të ndryshme;
- 61 lëndë janë regjistruar në aplikacionin e-pasuria;
- 516 lëndë janë regjistruar në sistemin e SIMFK-së;
- 43 vendime dhe autorizime për shërbime të transportit dhe
- 168 urdhër të punës për mirëmbajtje dhe servisim të automjeteve.

Me qëllim të ngritjes së nivelit të infrastrukturës fizike të prokurorive, sigurisë dhe shërbimeve në përgjithësi, janë zbatuar projektet kapitale si në vijim:

- Renovimet në PTH në Ferizaj, Gjilan, Pejë dhe Prizren sipas nevojave dhe planifikimeve;
- Përfundimi i objektit të PTH të Gjakovës dhe përgatitjet për akomodimin e stafit të prokurorisë;
- Fillimi i zbatimit të projektit kapital për renovimin e objektit të PSRK-së;
- Projekti për pajisjet e sigurisë në PTH të Gjilanit, Ferizajit, Prishtinës dhe Këshillit, projekt ky, i cili do të vazhdojë edhe në vitin e ardhshëm;
- Projekti për furnizim dhe montim të UPS-ve qendrore në ZKPSH dhe PTH dhe

- Projekti për blerjen e automjeteve.

Procese të tjera të rëndësishme së veçantë në fushën e shërbimeve të përgjithshme janë edhe ndërhyrjet për hapësirat e punës në Pallatin e Drejtësisë, pranimi dhe regjistrimi i donacionit nga EULEX-i dhe Ambasada Amerikane për pajisje të ndryshme, servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve kundër zjarrit, furnizim me tepih dhe perde etj.

Gjatë këtij viti janë kryer procese të ndryshme që kanë të bëjnë me menaxhimin e pasurive jofinanciare të sistemit prokurorial, si: regjistrimi, barkodimi, inventarizimi, vlerësimi dhe tjetërsimi i pasurisë jofinanciare.

Me qëllim të përmirësimit të shërbimeve të transportit për këtë vit janë siguruar automjete të mjaftueshme për nevoja të prokurorëve dhe stafit administrativ të sistemit prokurorial përmes blerjes dhe zbatimit të kontratës për vetura me qera. Përmes një marrëveshjeje formale është ofruar transporti për stafin e prokurorëve që janë të vendosura në Pallatin e Drejtësisë. Gjithashtu në përmirësim të menaxhimit të shërbimeve të transportit gjatë këtij viti ka filluar zbatimi i sistemit për menaxhimin e automjeteve për gjithë sistemin prokurorial.

8.4. Departamenti për Teknologji Informative

Bazuar në Rregulloren nr. 09/2016 për veprimtarinë, organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës funksionon edhe Departamenti për Teknologji Informative (më tej DTI).

Aktivitetet e DTI-së realizohen përmes:

- ❖ Divizionit të Infrastrukturës (rrjet dhe server) dhe
- ❖ Divizionit për Sisteme Elektronike (softuer).

Si aktivitete kryesore dhe të përgjithshme në kuadër të DTI-së janë:

- Gjatë vitit 2019, Departamenti i TI-së ka punuar në realizimin e prioriteteve, të cilat janë shtyllat e Planit strategjik të TI-së, që ka për qëllim digjitalizimin e procesit të punës në sistemin prokurorial;
- Janë përgatitur dy procedura standarde në fushën e TIK - Procedura standarde e veprimit për ofrimin e nivelit të shërbimeve të TI-së, dokument ky, i cili paraqet procedurën për ofrimin e shërbimeve ndërmjet DTI-së së SKPK-së dhe të gjithë të punësuarve në sistemin prokurorial, të cilët përdorin teknologjinë dhe sistemet kompjuterike të menaxhuara nga DTI-ja dhe Procedurat standarde të operimit për fshirjen e shënimeve në SMIL, që ka për qëllim përcaktimin e mënyrës së fshirjes së shënimeve, të cilat janë regjistruar gabimisht në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Lëndëve (SMIL) nga përdoruesit;

- Janë përgatitur dy udhëzues - Udhëzuesi për përdorimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) dhe Udhëzuesi për regjistrimin e lëndëve të vjetra në punë - SMIL;
- Implementimi dhe zbatimi i Projektit TIK/SMIL, gjegjësisht, vënia në zbatim e SMIL-it në të gjitha PTH-të;
- Investime në infrastrukturën harduerike – pajisje të TI për sistemin prokurorial,
- Implementimi i rrjetit (Internetit) sekondar (backup) për të gjitha prokuroritë;
- Zhvillimi, avancimi dhe vënien në zbatim të sistemeve të tjera elektronike: HelpDesk, sistemi i dosjeve të prokurorëve, sistemi i veturave, sistemi i rasteve të profilin të lartë – PSRK etj;
- Ngritja e niveli të sigurisë së informacionit.

8.4.1. Divizioni i Infrastrukturës (rrjet dhe server)

Në kuadër të Divizionit për Infrastruktura janë realizuar aktivitete që kanë të bëjnë kryesisht me çështje të rrjetit dhe serverit për gjithë sistemin prokurorial.

Aktivitet me më rëndësi për këtë vit janë si në vijim:

- Janë shpërndarë gjithsej 147 kompjuterë, 37 laptopë, 30 skanerë, 14 pajisje për nënshkrim elektronik, 5 TV, 20 shredderë, 80 printerë dhe 15 fotokopje;
- Në infrastrukturën e rrjetit është bërë instalimi i rrjetit sekondar (backup) në të gjitha prokuroritë e Kosovës. Pra, çdo prokurori është e pajisur me rrjetin primar dhe sekondar (backup) të Internetit. Në pajisjet e rrjetit janë vendosur licencat, të cilat mundësojnë filtrimin e rrjetit dhe kjo ndikon në rritjen e sigurisë së të dhënave.
- Është investuar në avancimin dhe rritjen e kapacitetit të Qendrës së të Dhënave, duke shtuar pajisje të avancuara në procesin e përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave;
- Është avancuar procesi i monitorimit të rrjetave kompjuterike, pajisjeve të TI-së dhe sistemeve elektronike në sistemin prokurorial, duke eliminuar të gjitha pengesat apo problemet që mundin të paraqiten;
- Janë trajnuar gjithsejt 45 zyrtarë të prokurorive për përdorimin e kompjuterit, ndërsa në bashkëpunim me Universitetin AUK RIT për siguri kibernetike janë trajnuar gjithsejtë 150 zyrtarë në të gjitha prokuroritë e Kosovës;
- Është trajtuar niveli i sigurisë brenda infrastrukturës së TI-së me prioritet të lartë, duke aplikuar praktikat më të mira për mbrojtjen ndaj qasjeve

të paautorizuara, sulmeve kibernetike, mesazheve me përmbajtje të padëshiruar, etj.

- Në prokuroritë themelore në Prishtinë, Pejë, Gjilan, Ferizaj dhe Prizren janë rregulluar dhomat për të mitur, të cilat posedojnë të gjitha kushtet dhe pajisjeve e nevojshme sipas standardeve (donacion i Ambasadës Amerikane) dhe
- Është avancuar sistemi i kamerave të sigurisë së objekteve në prokuroritë themelore Pejë, Ferizaj dhe Gjilan.

8.4.2. Divizioni për Sisteme Elektronike (softuer)

Në kuadër të Divizionit për Sisteme Elektronike janë realizuar një sërë aktiviteteve sipas planifikimit dhe nevojave.

Ndër aktivitetet kryesore të zhvilluara nga ky divizion janë:

- Me qëllim të ofrimit të shërbimeve më cilësore dhe reagimit më të shpejtë në fushën e TIK-ut, është zbatuar dhe vënë në zbatim sistemi i HelpDesk-ut në sistemin prokurorial, i cili mundëson paraqitjen e të gjitha problemeve, të cilat shfaqen në pajisjet e TI-së;
- Është zhvilluar dhe zbatuar sistemi elektronik për menaxhimin e burimeve njerëzore, i cili përmban të dhënat për stafin administrativ të sistemit prokurorial;
- Është digjitalizuar procesi i punës te dosjet e prokurorëve, duke mundësuar rekrutimin online, menaxhimin e dosjeve dhe tërë aktivitetet e tjera që ndërlidhen me dosjen e prokurorit;
- Është vënë në zbatim sistemi elektronik e-arkiva, i cili mundëson menaxhimin e të gjitha lëndëve që dorëzohen në Arkivin e Sekretariatit të KPK-së;
- Është avancuar sistemi i menaxhimit të pagesave të avokatëve, ekspertëve etj, sistemi i vijueshmërisë në punë dhe sistemi për menaxhimin e rasteve të profilit të lartë.
- Është zhvilluar dhe zbatuar sistemi elektronik, i cili mundëson editimin dhe fshirjen e të dhënave që janë plotësuar në mënyrë të gabuar nga SMIL-i.
- Është avancuar sistemi elektronik për menaxhimin e veturave dhe është bërë trajnimi i gjithë stafit për përdorim.
- Është në proces zhvillimi dhe implementimi i sistemit elektronik të menaxhimit të rasteve në Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave (donacion i GIZ-it gjerman).

8.5. Projekti TIK/SMIL

Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve është vënë në zbatim në prokuroritë themelore në Prishtinë, Pejë, Gjilan, Gjakovë, Ferizaj, Prizren dhe Prokurorinë Speciale nga data 13 nëntor 2018, ndërsa në Mitrovicë nga data 1 prill 2019.

Gjatë vitit 2019 është arritur një përdorim i përgjithshëm i SMIL-it, duke siguruar që të gjitha lëndët/rastet që janë pranuar të regjistrohen në SMIL nga shkrimorja, skanimin e dokumenteve dhe janë ndarë të prokurorët përkatës.

Gjithashtu është zhvilluar moduli i statistikave, i cili mundëson gjenerimin e raporteve në kohë reale nga SMIL për lëndët e trashëguara, të pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura, sipas prokurorive, departamentit, prokurorit dhe llojit të rasteve.

Numri i përgjithshëm i lëndëve që janë pranuar - regjistruar në SMIL për vitin 2019 është 57241 – raste (përfshihen të gjitha llojet e rasteve PPI-II, PPM, PPP dhe PPN).

Poashtu është arritur regjistrimi i lëndëve të vjetra në punë në të gjitha prokuroritë themelore dhe Prokurorinë Speciale.

Numri i përgjithshëm i lëndëve të vjetra në punë të regjistruara në SMIL është 64246 lëndë, prej tyre PTH Prishtinë – 34645 lëndë, PTH Ferizaj – 9400, PTH Prizren – 8917, PTH Mitrovicë – 7122, PTH Gjilan – 1782, PSRK – 909, PTH Pejë 810 dhe PTH Gjakovë 661.

Të angazhuar për regjistrimin e lëndëve të vjetra ishin stafi administrativ i prokurorive (zyrtarët ligjorë, referentët dhe bashkëpunëtorët profesionalë) gjithsejtë 100 zyrtarë në të gjitha prokuroritë.

Janë rekrutuar dy ekipe të trajnerëve për përdorimin e SMIL-it për regjionin e Prishtinës dhe të Mitrovicës. Numri i përgjithshëm i stafit që janë trajnuar për përdorimin e SMIL-it është 395 (prokurorë dhe stafi mbështetës). Niveli i përdorimit të SMIL-it në gjitha regjionet (Prishtinë, Pejë, Mitrovicë, Gjilan, Gjakovë, Ferizaj dhe Prizren) është duke treguar progres dhe bazuar në raportet të gjeneruar nga sistemi ky nivel ka arritur në 94 % të përdorimit të tij.

Nga data 22 korrik 2019 është vënë në zbatim nënshkrimi elektronik në prokuroritë themelore dhe PSRK. Kjo nënkupton që çdo person, i cili dorëzon lëndë në shkrimore te referenti i pranimit, letërkonfirmimi që gjenerohet nga SMIL-i, nënshkruhet përmes pajisjes, e cila mundëson që në mënyrë automatike të vendosë nënshkrimin në letërkonfirmim të palës që ka dorëzuar lëndën. Kjo do ta kursente kohën e referentit të pranimit dhe regjistrimi i lëndëve do të shkojë shumë më shpejt.

Është lansuar ndërlidhja e sistemeve elektronike në mes të KPK-së dhe Policisë së Kosovës. Kjo nënkupton që të gjitha raste, të cilat dorëzohen fizikisht nga PK-ja në prokurori, në të njëjtën kohë do të përcjelljen edhe në mënyrë elektronike nga sistemi elektronik.

Meqenëse është vlerësuar se SMIL-i si një ndër sistemet më të avancuara për

menaxhimin e lëndëve në gjykata dhe prokurori nga shtetet rajonale, kemi pasur dy vizita nga sistemi i drejtësisë të Republikës së Shqipërisë dhe të Maqedonisë së Veriut.

VII. PJESA E SHTATË

9. Aktivitetet e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë

Njësi, duke u mbështetur në kompetencat ligjore, gjatë vitit 2019 ka realizuar mbështetjen për Këshillin në proceset, si: mbikëqyrja dhe raportimi për punën e prokurorive, vlerësimin e performancës së prokurorëve, administrimin e prokurorive, rekrutimin, transferimin dhe avancimin e prokurorëve, vlerësimin e nevojave për trajnim të prokurorëve dhe mbajtjen e shënimeve dhe bazave të të dhënave për punën e prokurorive.

Për më tepër, Njësi është angazhuar në ofrimin e mbështetjes për hartimin e akteve nënligjore të Këshillit, hartim të dokumenteve strategjike dhe krahasimit të të dhënave statistikore për SMIL dhe regjistra fizikë.

Njësi këto aktivitete i ka zhvilluar nën mbikëqyrjen dhe koordinimin e drejtpërdrejtë të Drejtorit të NJSHPP-së dhe përmes:

- Zyrës për Mbikëqyrje, Analitikë dhe Verifikim Prokurorial;
- Zyrës për Statistika dhe
- Zyrës së Trajnimeve.

9.1. Zyra për Mbikëqyrje, Analitikë dhe Verifikim Prokurorial

Zyra për Mbikëqyrje, Analitikë dhe Verifikim Prokurorial (më tej: ZMAVP) gjatë vitit 2019 ka ushtruar përgjegjësitë e përcaktuara me rregullore, duke ofruar mbështetje profesionale, administrative dhe teknike për Këshillin, përkatësisht, Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës (më tej: SKPK), Prokurorin e Shtetit dhe komisionet e përhershme dhe ad hoc të Këshillit, në të gjitha proceset e zhvilluara nga këto, ku ka qenë i përcaktuar roli i Njësitit përmes ZMAVP-së.

ZMAVP ka mbështetur proceset e rekrutimit, transferimit, avancimit dhe vlerësimit të performancës së prokurorëve, duke përfshirë dhe administrimin e prokurorive dhe hartimin e raporteve për përfundimin e këtyre të proceseve, si dhe ka hartuar raporte periodike (tre, gjashtë, nëntëmujore dhe vjetore) të punës së Prokurorit të Shtetit, Mekanizmit përcjellës ndërinstitucional për harmonizimin e statistikave, si dhe raporteve analitike, krahasuese dhe të punës së mekanizmave të ndryshëm të sistemit prokurorial.

9.2. Mbështetja e komisioneve të Këshillit

ZMAVP ka ofruar mbështetje të vazhdueshme për Këshillin dhe komisionet e përhershme dhe ad hoc të Këshillit si në vijim;

- Këshillin dhe Sekretariatit në hartimin e Planit të punës për vitin 2019, Raportin e punës për vitin 2018, përfshirjes në hartimin e konceptdokumentit për organizimin e administratë së sistemit prokurorial, hartimit të listës së rreziqeve, hartimi i draftstrategjisë për trajtimin me prioritet të korrupsionit dhe krimit ekonomik;
- Komisionin për Vlerësim të Performancës së Prokurorëve (KVPP), gjatë vlerësimit të performancës së prokurorëve me mandat fillestar dhe atyre me mandat të përhershëm. Në këtë kontekst, fillimisht janë identifikuar prokurorët, të cilët duhet t'i nënshtrohen vlerësimit të performancës gjatë vitit 2019;
- Komisionin e Rekrutimit të Prokurorëve në kuadër të procesit të zhvilluar gjatë vitit 2018, por që ka përfunduar me dekretim në vitin 2019;
- Panelin Vlerësues dhe Komisionin për Rishqyrtim për procesin e emërimit të Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë;
- Komisionin për Transferim dhe Avancim të Prokurorëve për realizimin e pesë (5) proceseve të avancimit dhe dy (2) proceseve të transferimit të prokurorëve të prokurorisë themelore;
- Komisionin për Administrimin e Prokurorisë si komision i përhershëm. Në këtë drejtim është kontribuar në organizimin e takimeve dhe vizitave në terren të Komisionit, mbikëqyrjen e regjistrave në prokurori dhe hartimin e draft raportit dhe planit të punës së Komisionit, si dhe raporteve e dokumenteve tjera të punës së Komisionit;
- Komisionin për Çështje Normative si komision i përhershëm për hartimin e draftit të Rregullores për Njësitin për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë, draftit të Rregullores për zhvillim profesional në sistemin prokurorial, draftit të Rregullores për dosjen personale të prokurorëve, draftit të Rregullores për vlerësimin e performancës së prokurorëve.

9.3. Hartimi i raporteve

Gjithashtu, ZMAVP-i ka hartuar raporte pune, analitikë, krahasuese dhe raporte të tjera si më poshtë:

- Raporti analitik për numrin e nevojshëm në të gjitha prokuroritë;
- Raportin analitik për numrin e kallëzimeve penale të hedhura në vitin 2018;
- Raport për numrin e lëndëve me kryes të panjohur për gjashtëmuajorin e parë 2019;
- Raport për zbatimin e trajnimeve të detyrueshme nga ana e prokurorëve;
- Raportet krahasuese mes shënimeve statistikore të regjistrave fizikë,

raporteve të punës së prokurorëve dhe SMIL-it për tri (3) prokurori themelore;

- Raportet periodike (3, 6 dhe 9 mujore dhe vjetor) të punës së Prokurorit të Shtetit;
- Raportet periodike (3, 6 dhe 9 mujore dhe vjetor) të Mekanizmit përcjellës ndërinstitucional për harmonizimin e statistikave;
- Raporti analitik 6-vjeçar (2013-2018) për PSRK dhe prokuroritë themelore për veprat penale karakteristike dhe
- Raporti i gjeografisë së krimit (2013-2018).

9.4. Zyra për Statistika

Zyra për Statistika (më tej: ZS) gjatë vitit 2019 ka kryer punët sipas Planit të punës dhe punët e tjera sipas kompetencës së përcaktuar me rregullore dhe kërkesave. ZS-ja ka grumbulluar të dhëna statistikore për punën e prokurorive dhe prokurorëve, i ka përpunuar ato dhe i ka hartuar raportet statistikore në baza mujore, periodike dhe vjetore. Ajo ka ofruar mbështetje me të dhëna statistikore të nevojshme për punën e komisioneve të përhershme të KPK-së, koordinatorëve nacionalë të caktuar nga KPK-ja për luftimin e krimit sipas grupeve të të veprave penale. ZS, po ashtu, ka mbështetur DTI-në gjatë fazës së implementimit të SMIL-it, si në vijim:

9.4.1. Mbështetja e komisioneve, koordinatorëve nacionalë, DTI-së dhe ZMAVP-it

ZS-ja ka ofruar mbështetje profesionale nga fushëveprimi i saj, me kërkesa nga komisionet e përhershme të Këshillit, koordinatorët nacionalë për luftimin e krimit sipas grupeve të të veprave penale, DTI-së dhe ZMAVP-it, si në vijim:

- Komisioni për vlerësimin e performancës së prokurorëve është mbështetur me informata dhe të dhëna statistikore për punën e të gjithë prokurorëve, të cilët i janë nënshtruar procesit të vlerësimit të performancës;
- Komisioni për Administratë është mbështetur me të dhëna statistikore për gjendjen e rasteve në prokurori, po ashtu, ky Komision është mbështetur edhe gjatë vizitave monitoruese në zbatimin e SMIL-it;
- Zyra e Koordinatorit nacional për luftimin e krimeve ekonomike është mbështetur me të dhëna dhe informata që i përkasin këtyre veprave penale. Po ashtu në mbështetje të punës së kësaj zyreje rreth grumbullimit të informatave për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë së fituar me vepra penale ishte e angazhuar edhe një zyrtarë e ZS-së.
- Koordinator kombëtar për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore është

mbështetur me të dhëna statistikore për rastet dhe personat nga ky grup i veprave dhe me të dhëna për viktimat e trafikuar;

- Koordinatorin nacional për luftimin e veprave penale të korrupsionit është në mbështetje të vazhdueshme nga ZS-ja me të dhëna të ndryshme statistikore për këtë grup të veprave penale;
- Departamenti i Teknologjisë Informative është mbështetur nga ZS-ja gjatë procesit të hartimit të raporteve statistikore që do t'i gjenerojë SMIL-i. Po ashtu, në vazhdimësi, zyrtarët e ZS-së në baza ditore monitorojnë vlefshmërinë e pilotraporteve të prodhuara nga SMIL-i;
- ZMAVP-ja dhe ZS-ja bëjnë një punë të përbashkët në verifikimin e të dhënave statistikore të raportuara. ZS-ja këtë zyrë e mbështet në aspektin teknik dhe profesional në përdorimin e të dhënave statistikore gjatë përpilimit të raporteve për performancën e prokurorive dhe përpilimit të raportit për grupet e veprave penale nga mekanizmi përcjellës.

9.4.2. Raportet e rregullta

Zyra për Statistika gjatë vitit 2019 ka përpiluar raporte të rregullta statistikore (periodike: tre, gjashtë, nëntëmujore dhe vjetore) për punën e prokurorive, si në vijim:

- a. Raportet mujore statistikore për:
 - Ngarkesën e prokurorëve me lëndë dhe efikasitetin në zgjidhjen e tyre, sipas llojit të regjistrave për 171 prokurorë të prokurorive themelore, PSRK-ja dhe PA-ja;
 - Gjendjen e rasteve në prokurori: sipas prokurorive, departamenteve dhe sipas llojit të regjistrave;
 - Gjendjen e rasteve sipas grupeve të veprave penale nga mekanizmi përcjellës nga regjistri PP dhe PPN.
- b. Raportet për përmbushjen e Normës Orientuese për vitin 2018 për secilin prokurorë të prokurorive themelore, Prokurorisë Speciale dhe Prokurorisë së Apelit. Raport i secilit prokuror për % e përmbushjes së Normës Orientuese është vendosur si dokumentacion në dosjen personale si dokument personal;
- c. Raportet periodike statistikore: tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore dhe vjetore për:
 - Raporte standarde për punën e prokurorive për lëndët me veprat penale për: kryes të veprave penale me persona madhorë (PP); kryes të veprave penale persona të mitur (PPM), kryes të panjohur të veprave penale (PPP), pretendimet për kryerjen e

veprave penale (PPN), ndihmë juridike ndërkombëtare (NJN) sipas prokurorive dhe departamenteve;

- Raporte standarde për grupet e veprave nga mekanizmi përcjellës: armët, droga, krimi i organizuar, krimet ekonomike, korrupsioni, kontrabandë me migrantë, shpëlarje parash, veprat penale të motivuara nga urrejtja dhe trafikimi i qenieve njerëzore sipas parashtruesve të veprave penale, mënyrës së zgjidhjes kryerjes, veprimeve të ndërmarrura nga prokurori, vendimeve të gjykatës dhe ankesave të prokurorëve në vendimet e gjykatës;
- Raportet për aplikimin e procedurave alternative;
- Raportet e integriteteve evropiane, veprat penale kundër komunitetit të LGBTI-së, kundër gazetarëve dhe dhunës në familje dhe
- Raporte përshkruese për punën e prokurorive dhe veprave penale karakteristike nga mekanizmi përcjellës.

9.4.3. Raportet e veçanta

Po ashtu, ZS-ja, gjatë vitit 2019, ka përpiluar raporte të veçanta statistikore, si në vijim:

- Raporte mujore për rastet me vepra penale të korrupsionit për lëndët e pazgjidhura, lëndët e pranuar, lëndët e zgjidhura sipas numrit të lëndës, datës së pranimit të lëndës, parashtruesit të kallëzimeve penale, mënyrës së zgjidhjes, datës së zgjidhjes dhe vendimeve të gjykatave përkitazi me aktet akuzuese sipas kërkesës së IKD-së dhe
- 53 raporte dhe informata të ndryshme statistikore me të dhëna për periudha të ndryshme kohore, sipas kërkesave të botës akademike, mediave, institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, prokurorëve pjesëmarrës në konferenca dhe punëtori të ndryshme sipas kërkesave.

9.5. Zyra për Trajnime

Gjatë vitit 2019, Zyra për Trajnime në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë së Kosovës dhe donatorë të tjerë ka koordinuar aktivitetet për ngritjen profesionale të prokurorëve dhe stafit administrativ.

Për trajnimin e prokurorëve dhe stafit mbështetës, Zyra për Trajnime ka koordinuar punën me Akademinë e Drejtësisë, Ambasadën Amerikane në Prishtinë, Departamentin e Drejtësisë së SHBA-së, OSBE-së, UNDP-së, Ambasadën Norvegjeze, Ambasadën Holandeze, Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë dhe

projektet e ndryshme të BE-së, etj.

Aktivitetet e arsimit ligjor për prokurorë janë realizuar në formë të trajnimeve dhe konferencave brenda dhe jashtë shtetit për 98 tema.

Po ashtu, sipas kërkesave të veçanta, Zyra ka përgatitur raporte për të mbështetur Komisionin për Vlerësimin e Përfomancës së Prokurorëve dhe për nevoja individuale ose grupe për të dëshmuar pjesëmarrjen e prokurorëve në trajnime për tema të caktuara.

Zyra për Trajnime, po ashtu, ka hartuar:

- Vlerësimin e nevojave për trajnim për prokurorë dhe stafin administrativ të sistemit prokurorial;
- Raportet periodike dhe njëvjeçar për pjesëmarrjen e prokurorëve në aktivitetet trajnuese;
- Raportet individuale për pjesëmarrjen e prokurorëve në aktivitete të ndryshme të edukimit ligjor brenda dhe jashtë shtetit, sipas kërkesës së Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve për prokurorët që i nënshtrohen procesit të vlerësimit të performancës dhe
- Raportet individuale për pjesëmarrjen e prokurorëve në aktivitetet e ndryshme të edukimit ligjor si jashtë dhe brenda shtetit, sipas kërkesës së Komisionit për Transferim dhe Avancim të Prokurorëve.

10. Sfidat

Nga prezantimi i punëve të realizuara gjatë kësaj periudhe raportuese mund të vërehet intesiteti i përbushjes së mandatit ligjor nga Këshilli, megjithatë, në punën e tij, Këshilli dhe strukturat e tij janë ballafaquar edhe me sfida të shumta, ku ndër më kryesoret veçojmë:

- Mosplotësimi i përbërjes së Këshillit me tre (3) anëtarë joprokurorë, që me hyrjen në fuqi të Ligjit për Këshillin në prill të këtij viti, nuk është përgjegjësi e Këshillit as përzgjedhja e as procedurat teknike të shpalljes së konkursit;
- Mungesa e legjislacionit për të rregulluar mënyrën e kompensimit të ekspertizave;
- Specializimi i prokurorëve për trajtimin e krimeve karakteristike (korrupsioni, krimi i organizuar, krimi ekonomik dhe krimet kibernetike);
- Mosrespektimi i parimit të transparencës përmes disa publikimeve mediale që ndikojnë drejtpërdrejt në dëmtimin e besimit të publikut në sistemin prokurorial;
- Plotësimi i pozitave të lira të stafit administrativ si rrjedhojë e ligjit të ri për

zyrtarë publik dhe ligjit për pagat;

- Infrastruktura fizike (zgjerimi i hapësirave për Këshillin dhe Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Prokurorisë Themelore të Mitrovicës, që gjendet në objekt me qera) dhe
- Ngritja e kapaciteteve profesionale të personelit të sistemit prokurorial.

